

KALLARATI



Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, **nr. 114**, janar – mars 2025
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter **Hysaj**
Ky numër u sponsortizua nga:
Besnik Gjonbrataj



BRIGADA V SULMUESE DHE KALLARATASIT NË PËRBËRJE TË SAJ

Brigada e Pestë Sulmuese u përrua më 20 janar 1944 në Bramushje të Tërbaçit, rrethi i Vlorës, me një efektiv prej 960 partizanësh të rreshtuar në pesë batalione. Bërthama e saj prej tre batalionesh ishte krijuar më 28 nëntor 1943 në fshatin Gumenicë të Vlorës. Kjo brigadë zhvilloi shumë luftime dhe beteja kundër pushtuesve, nga jugu në veri e deri në Kosovë. Në Brigadën e 5-të Sulmuese u rreshtuan edhe 7 kallaratas, nga të cilët 4 dhanë jetën dhe u shpallën dëshmorë të atdheut...

Faqe 3



LUMI I VLORËS, KY DET PASURISH KOMBËTARE



Faqe 6

GËZUAR 7 MARSIN, "DITËN E MËSUESIT"!



PROFESOR ARDIT BIDO I BASHKOHET NISMËS SONË



Shoqata "Kallaratit" dhe të gjithë kallaratasit shprehin mirënjohjen e tyre më të thellë për intelektualin e analistin e shquar, Profesor Dr. Asoc. Ardit Bido, jo vetëm për mbështetjen e tij të palëkundur ndaj çështjes mbarëkombëtare dhe kontributin e çmuar në njohjen e historisë së Kallaratis, në mënyrë të veçantë qëndresën e tij në vitin 1914, por edhe për këtë gjest simbolik dhe domethënës në kuadër të nismës "Mbill edhe ti një pemë". Dhurimi i një peme.

Faqe 11

TË NJOHIM KALLARATASIT BRENDA E JASHTË VENDIT

Faqe 7

FALËNDERIM I KRYETARIT TË SHOQATËS NË KËTË FILLIM VITI

Në emër të Kryesisë së Shoqatës “Kallarati” dhe në emrin tim si kryetar, në këtë fillim viti falënderojmë të gjithë anëtarët e saj, por edhe miqtë dhe dashamirësit e Kallarait, për mesazhet, komentet dhe kartolinat e dërguara në adresë të shoqatës, të cilat i vlerësojmë shumë. Viti që lamë pas ishte i mbushur me aktivitete patriotike dhe kulturore, të cilat kontribuan në ruajtjen e vlerave tona si komunitet dhe si fshat. Si kryetar, ju siguroj se edhe ky vit që sapo ka nisur do të sjellë aktivitete të larmishme, të cilat, me angazhimin dhe mbështetjen e secilit kallaratas, do të realizohen me sukses. Së shpejti do të mblidhet kryesia e shoqatës në Vlorë për të shqyrtuar të gjitha mendimet e ardhura nga ju dhe për të miratuar një program vjetor, i cili do të bëhet i ditur në faqen zyrtare të shoqatës në Facebook. Faleminderit dhe u uroj të gjithëve një vit të mbarë për ju dhe familjet tuaja, si dhe për të gjithë miqtë, shokët dhe dashamirësit e Kallarait tonë të dashur.

Kastriot Karabolli
Kryetar i shoqatës “Kallarati”



PROGRAMI I SHOQATËS “KALLARATI” PËR VITIN 2025

1. TRE AKTIVITETET KRYESORE TË VITIT

- 1 mars 2025 – Kurorëzimi i nismës “Mbill edhe ti një pemë ose lule në vendlindje, në Kallarati”.
- 18 maj 2025 – Pikniku pranveror në “Fshatin e Djegur”.
- 16 gusht 2025 – “Takimi i Brezave” në Kallarati.

2. AKTIVITETE PËR DATAT HISTORIKE

- 7 Mars – Dita e Mësuesit dhe 8 Mars – Dita e Nënës: Festime në degët përkatëse, sidomos në Kallarati.
- 5 Maj – Dita e Dëshmorëve: Kujtim dhe homazhe pranë lapidarit në Kallarati dhe në Vlorë, në bashkëpunim me organizatat përkatëse.
- 28–29 Nëntor – Dita e Pavarësisë dhe Dita e Çlirimit: Homazhe dhe festime në bashkëpunim me organizatat e Veteranëve dhe Dëshmorëve të Atdheut.

- Rivendosja e pllakës punuar nga Agim Mataj: “Kallarati, Kuç e Bolenë/ në lum ç’e zunë dyfeknë”: Deri në qershor 2025 në hyrje të fshatit.

3. AKTIVITETE KULTURORE NË KALLARAT

- 18 maj 2025 – Piknik Pranveror me pjesëmarrje të bashkëfshatarëve brenda dhe jashtë vendit.
- 16 gusht 2025 – Takimi i Brezave me program të veçantë kulturor.

4. AKTIVITETE TË VITIT TË RI 2026

- Mbrëmje festive në fund të dhjetorit në: Kallarati, Vlorë, Tiranë, Greqi, Itali e vende të tjera ku ka kallaratas. Organizimi në bazë degësh.

5. AKTIVITETE KULTURORE DHE ARTISTIKE ONLINE

Kurse për fëmijët deri në moshën 18 vjeç:

- Eseja më e bukur për vendlindjen (janar–prill) – shpallet në maj.
- Poezia më e bukur për Kallaratin (maj–korrik) – shpallet në gusht.
- Piktura më e bukur me temë Kallaratin (gusht–tetor) – shpallet në nëntor.
- Kartolina më e bukur e Vitit të Ri 2026 (shtator–nëntor) – shpallet në dhjetor.

Komisionet e vlerësimit caktohen nga Kryesia.

6. NGRITJA E GRUPIT ARTISTIK

- Për Piknikun Pranveror dhe Takimin e Brezave – me burra e gra me kostume popullore. Udhëheqësi artistik dhe sponsorët caktohen nga kryesia.

7. FUNKSIONIMI I GAZETËS “KALLARATI” (ONLINE)

- Botim çdo 2 muaj me 12–24 faqe. Pasqyrim i aktiviteteve, historisë, figurave të shquara, krijimeve të brezit të ri dhe jetës së emigrantëve kallaratas.

8. FEJSBUKU I SHOQATËS

- Të shërbejë si kanal komunikimi, informimi dhe sensibilizimi për gjithë komunitetin. Të administrohet nga një administrator i caktuar nga kryesia me korrespondentë në çdo qytet.

9. BASHKËPUNIMI ME SHOQATA TË TJERA

- Me fshatrat fqinjë (Bolena, Kuçi, Vranishti, Tërbaçi) dhe me Shoqatën “Labëria”. Pjesëmarrje

në aktivitete të ndërsjella.

10. RIORGANIZIMI I DEGËVE TË SHOQATËS

- Nga shkurti deri në qershor, riorganizimi dhe krijimi i degëve të reja në: Kallarati, Vlorë, Himarë, Sarandë, Delvinë, Fier, Tiranë, Greqi, Itali, SHBA, Kanada, Angli, etj.

11. HISTORIKU I KALLARATIT

- Diskutim dhe miratim në Vlorë i historikut të hartuar nga grupi i punës. Botimi synohet të realizohet brenda vitit 2025, pasi të sigurohen fondet.

12. STIMUJ MORALË

- Dhënie “Certifikatash Mirënjohjeje” për figura të shquara të Kallarait ose individë që kanë kontribuar për fshatin.

13. MBJELLJA E PEMËVE DEKORATIVE

- 1 mars 2025 – Dita e pyllëzimit të qendrës së fshatit, në kuadër të nismës “Mbill një pemë ose lule në vendlindje”.

14. FINANCIMI I SHOQATËS

- Caktohet një financier i përgjithshëm dhe financierë lokalë për çdo degë.
- Kontribut vjetor minimal prej 20 mijë lekë të vjetra (me përjashtim për familjet me të ardhura të pakta).
- Aktivitetet e mëdha do të financohen me ndihmën e biznesmenëve kallaratas.
- Transparenca e të ardhurave të bëhet çdo 3 muaj ose pas çdo aktiviteti.

Kryesia e Shoqatës “Kallarati”

BRIGADA V SULMUESE DHE KALLARATASIT NË PËRBËRJE TË SAJ

Brigada e Pestë Sulmuese u përrua më 20 janar 1944 në Bramushje të Tërbaçit, rrethi i Vlorës, me një efektiv prej 960 partizanësh të rreshtuar në pesë batalione. Bërthama e saj prej tre batalionesh ishte krijuar më 28 nëntor 1943 në fshatin Gumenicë të Vlorës. Kjo brigadë zhvilloi shumë luftime dhe beteja kundër pushtuesve, nga jugu në veri e deri në Kosovë. Në Brigadën e 5-të Sulmuese u rreshtuan edhe 7 kallاراتas, nga të cilët 4 dhanë jetën dhe u shpallën dëshmorë të atdheut:



1. Hasan Laze Qejvanaj (dëshmor)
2. Nexhip Sheraj (dëshmor)
3. Zyber Sheraj (dëshmor)
4. Shuaip Sheraj (dëshmor) – të tre vëllezërit Sheraj me banim në Hysoverdh.
5. Ahmet Rait Karabollaj
6. Hariz Goxhaj
7. Qamile Goxhaj (burrë e grua)

*Lavdi Brigadës së Pestë Sulmuese!
Lavdi dëshmorëve të Kallaratis në këtë brigadë!*
(Referuar shënimeve të të ndjerit Seit Jonuzaj)

BRIGADA E GJASHTË SULMUESE DHE KALLARATASIT NË PËRBËRJE TË SAJ

Brigada VI Sulmuese e UNÇSH “Hero i Popullit” u formua në qytetin e Përmetit më 26 janar 1944. Në të u rreshtuan batalionet partizane “Asim Zeneli”, “Abaz Shehu”, “Baba Abazi” dhe “Naim Frashëri”, me një efektiv prej 912 partizanësh dhe partizanesh. Më vonë, në brigadë u përfshi edhe batalioni “Zaho Koka”.


- Veprimet më të rëndësishme të saj përfshijnë:
- Luftimet në luginën e Përmetit për përballimin e Mësymjes së Përgjithshme armike të dimrit 1943–1944
 - Luftimet në Lunxhëri dhe në Tepelenë (shkurt)
 - Spastrimi i Mallakastrës, Rrëzomës së Delvinës, Margëlliçit (Patos) dhe Mavrovës (mars)
 - Luftimet e qershorit 1944 në Kurvesh, Mesaplik etj.
 - Thyerja e operacionit armik në Dukaj–Tepelenë (korrik)
 - Luftimet në Labinot–Elbasan (shtator)
 - Çlirimi i Mirditës, Shupalit, Gojanit dhe Fushë–Arrëzit (tetor–nëntor)
 - Shpartallimi i forcave reaksionare në Dukagjin (nëntor)

Veçanërisht të rëndësishme ishin luftimet përtej kufijve në ndihmë të vëllezërve kosovarë dhe popujve të Jugosllavisë: Kalaja e Medunit, Bresku–Lieva–Reka, Verusha, Suhogora, Drinsko dhe Vishegrad. Pas 7 ditësh marshimi të sforcuar, më 12 mars 1945, brigada parakaloi në Mitrovicë. Nga 10 qershori deri në dhjetor, ajo zhvilloi luftime në Shkup, Valë, Manastir dhe Ohër kundër bandave reaksionare. Më 7 dhjetor 1945, u përqendrua në Korçë. Në rrugën e saj luftarake u rreshtuan mbi 1700 partizanë. Ajo i shkaktoi armikut mijëra të vrarë e të plagosur, kapi 1947 robër. Nga radhët e saj ranë dëshmorë 191 partizanë dhe 12 partizane.



- Kallaratasit pjesëmarrës në këtë brigadë, disa dëshmorë të atdheut:
1. Avdul Demiraj (Dëshmor i Atdheut)
 2. Hamza Qejvanaj (Dëshmor i Atdheut)
 3. Ilmi Boshaj (Dëshmor i Atdheut)
 4. Sinan Xhemili (Tozaj)
 5. Mehmet Karabollaj
 6. Çune Qejvanaj
 7. Fuat Goxhaj
 8. Hamit Qejvanaj
 9. Numan Goxhaj
 10. Mato Hoxhaj
 11. Mehmet Zhibaj
 12. Xhemal Gjonaj
 13. Sefer Jovanaj
 14. Qazim Mataj
 15. Çelo Karabollaj

Lavdi jetës dhe veprës së partizanëve dhe dëshmorëve të kësaj brigade, në veçanti atyre kallاراتas!



GËZUAR 7 MARSIN, “DITËN E MËSUESIT”!

Të dashur mësues!

Me përlujë dhe mirënjohje të thellë ju urojmë në këtë ditë të shenjtë, ju që me përkushtim, dije dhe dashuri keni ndriçuar mendjet e brezave dhe keni mbjellë farën e diturisë në zemrat e fëmijëve tanë.

Urimi ynë shkon për të gjithë mësuesit kallarratas, që ndër vite, brenda dhe jashtë Kallarait, kanë dhënë kontribut të vyer në arsimim dhe edukim.

Respekt për ata që edhe sot mbajnë mbi supë këtë mision fisnik, si dhe për ata që pas një jete shërbimi janë në pension apo në fusha të tjera.

Mirënjohje për mësuesit jokallaratas, që shërbyen në shkollën “Mumin Selami” dhe kudo në Shqipëri, duke qenë pjesë e historisë sonë arsimore.

Homazh për mësuesit që nuk janë më mes nesh – vepra e tyre mbetet e pavdekshme në kujtesën dhe shpirtin tonë.

Lavdi dhe nderim për mësuesit shqiptarë!



GËZUAR 8 MARSIN, “FESTËN E NËNËS”!

Me përlujë dhe mirënjohje të thellë, ky urim shkon për nënat, gratë dhe motrat kallarratase, por edhe për çdo nënë shqiptare që me durim dhe përkushtim ka qenë e mbetet themeli i familjes dhe i shoqërisë.

Nëna është drita e shtëpisë, zemra e çdo familjeje, forca që na frymëzon dhe na mban të fortë. Ajo është shpirti i dhembshurisë, zëri që na ngushëllon kur rrugët bëhen të vështira dhe duart që na ngrenë kur rrëzohemi. Është dashuri pa kushte, sakrificë e palodhur, forcë e pashtershme.

Gëzuar, nënat dhe gratë e Kallarait!

Ju që gjithmonë keni qenë shtylla të familjes dhe të komunitetit! Ju që keni rritur, edukuar breza dhe qëndroni në ballë të çdo nisme për vendlindjen – siç dëshmuat me kontributin tuaj në mbjelljen e pemëve në Kallarat, duke i dhënë jetë një ëndrrë për të ardhmen!

**8 MARS 2025- NË KALLARAT
FESTOHET DITA E NËNËS**

Gratë dhe nënat e Kallarait, si çdo vit, festuan më 8 Mars 2025 në vendlindjen e tyre, në klubin e Zeqo Hoxhaj, duke ruajtur traditën e bukur të solidaritetit dhe bashkimit.

Një falënderim i veçantë për to, për këtë festim domethënë që përcjell mesazhin:

“Gratë e Kallarait që banojnë në fshat janë gjithmonë bashkë – në festa, në gëzime dhe në ditë të vështira.”

Gëzuar 8 Marsin!

Falënderojmë djemtë kallarratas dhe jo vetëm: Kastriot Sadikun, Ladi Kondin, Fejzi Xhaferaj, Muhedin Qejvanin, Ilir Memushaj, Margarit Lame Shakaj dhe të zotën e lokalit Erges Hoxhaj, të cilët, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për nënat, motrat dhe bashkëfshataret e tyre, sponsorizuan këtë drekë simbolike – të thjeshtë, por shumë domethënëse – që mbart në vetvete dashuri dhe respekt të thellë.

Mirënjohje të gjithëve!



Lefter Hysaj: “Mësuesit janë ushtarë të atdheut pa uniformë” - kjo duhet të deviza e çdo mësuesi të ndërgjegjshëm. Intervistë dhënë me rastin e festës së mësuesit, dhënë Qendrës për Hapje dhe Dialog.

Lefter Hysaj, me 40 vite përvojë në shërbim të arsimit në Kukës, Vlorë dhe fshatrat e Vlorës, ka kaluar jetën mes brezave, duke e konsideruar profesionin e mësuesit si një mision në shërbim të vendit. Ai gjithashtu përcjell mesazhin për t'i nxitur të rinjtë të pasionohen për dijen.

Urime të gjithë arsimtarëve në këtë ditë speciale!

DUDI STRATJA NUSJA ME FLAMUR

NGA ÇIZE XHAFERAJ
(ish-drejtor i shkollës në Kallarat)

Kallarasit në shekuj janë shquar si patriotë e atdhetarë. Aty kanë lindur burra kazaje e vilajeti, që kanë zgjidhur nyje të vështira, si dhe gra që me bëmat e ligjërimit të tyre kanë lënë gjurmë historie. Dekada më parë bisedoja me një grua moshatare dhe ajo mes të tjerash në tregoi dhe për vitet e shkuara. Mes të tjerash më tha: “Qyq më që (ishte shprehja e saj dashamirëse) në kohën tonë ne vinim nuse me flamur dhe vetëm të hipur në kalë”.

Për një nga këto nuse me flamur mendova të shkruaj. Ajo është Dudi Hodo Stratja, apo siç njihej Dudi Hodja. Dudia ishte bijë e kuçiotë. Në dekadën e fundit të shekullit të 19-të u martua me Çelo S. Stratin në Kallarat. Vitet rridhnin, ajo u bë e respektuar në vëllazëri dhe më gjerë. Shtëpia e saj ishte derë e hapur. Bujaria, fisnikëria e mikpritja e saj ka mbërritur në ditët tona tek shprehja: “Më me shije një ve (vezë) e Dudës se një pjatë meze me mish”. Jeta nuk qe e lehtë për Dudën. Ajo provoi plagë zemre, por nuk u ligështua, kur e donte puna, bëhej pjesë e veprimtarive që organizoheshin në fshat. Një gjë e tillë ka gjurmë të thella tek të gjithë kallarasit, si grua me vlera që lartësoi jo vetëm atë, por gruan kallaratase. Një ngjarje ishte ajo e 28 nëntorit 1919-ës. Paria e fshatit organizoi festimin e 7-vjetorit të shpalljes së pavarësisë. Atë ditë në Qafë të Ubavit, tek shtëpia e Zenepe Toçes, që shërbente edhe si shkollë, ishte mbledhur i gjithë fshati. Pjesë e kësaj festë ishte edhe Dudia. Atë ditë ajo nxori nga sepetia e nusërisë, që ishte e gjitha e veshur me punime argjendi, flamurin, bezen e kuqe me shqiponjë, që i kishte mbuluar shtatin ditën që u bë nuse. E kishte ruajtur flamurin si kujtim. Shqiponja me bezen e kuqe me pasqyrën te balli kishte një domethënie për rrugën e jetës së saj. U valëvit ai flamur i nusërisë së Dudisë atë ditë te shtëpia - shkollë, si një sozi e atij që Ismail Qemali dhe patriotët shqiptarë ngritën në Vlorë më 28 nëntor 1912 dhe shpallën pavarësinë e Shqipërisë. Gjendjen e mbuloi gëzimi e hareja. Të pranishmëve u foli mësuesi Meçan Selami që ishte anëtar i shoqërisë patriotike, ndërsa nxënësit recituan vjersha e pjesëmarrësit kënduan e hodhën valle - shkruan në kujtimet e tij pjesëtari i ngjarjes Hasan Shamua (Kallarat). Që nga ajo ditë Qafa e Ubavit u bë qendra historike e fshatit. Gëzimi i festës, i asaj “Dite të Madhe” për kallarasit nuk zgjati shumë. Drejtuesit e fshatit dhe



nënë Dudia u ndeshën me reprezaljet e pushtuesve italianë. Në fillim të dhjetorit erdhi në Kallarat një patrullë karabinierësh italianë. Ata arrestuan mësuesin Meçani Selami, Remzi Janjin, Shamo Meçen, Alem Toton, Selam Bajramin dhe Dudë Hoden. Të lidhur i shoqëruan për në Himarë. Pas një procedimi të rëndë, të lidhur dhe në këmbë i

çuan në Vlorë. Aty i mbyllën në burgun e Medresesë. Pas 4 muajsh burgim i nxorën në gjyqin ushtarak (Tribunale Militare di Guerra). Prokurori kërkoi dënimin me vdekje për Meçan Selamin, Remzi Janjin, Shamo Meçen, Alem Toton, Selam Bajramin dhe për Dudi Hoden 3 vjet burgim. Provoi Dudi Hodja dhe vëllezërit e saj bashkë-

Dudi Hodo Stratja, apo siç njihej Dudi Hodja. Dudia ishte bijë e kuçiotë. Në dekadën e fundit të shekullit të 19-të u martua me Çelo S. Stratin në Kallarat. Vitet rridhnin, ajo u bë e respektuar në vëllazëri dhe më gjerë. Shtëpia e saj ishte derë e hapur.

shatarë qelitë e burgjeve të pushtuesve italianë, në atë dimër të acartë të atij viti, por nuk u gjunjëzuan. Kallarasit me dashurinë dhe respektin që kishin për njëri - tjetrin nuk qëndruan në heshtje. Ata grumbulluan 6000 lireta, prej të cilave 3000 i pagoi Hodo Kalemi dhe paguan avokatin italian. Në ditët e fundit të marsit 1920 fituan pafajësinë. Dudia kishte një djalë të vetëm Feinin. E kishte ushqyer me dashurinë për vatanin, që kur duhej t’i dilte zot. Dhe pak muaj më pas, Feini vihet në krye të çetës luftarake të kallaratase në luftën e Vlorës kundër pushtuesve italianë. Në fushën e betejës Feini u shqua si komandant i zoti dhe luftëtar trim. Bashkëfshatarët për të kanë shkuar, e kanë epiteluar e portretizuar dhe këngë i kushtuan: Feim Çelo Kallarati/ burrë trim e fjalë vrapi/ i çau si ujku i marsit”.

Vite e dekada që pasuan, veprimtaria patriotike e atdhetare e nënë Dudisë, e bashkëfshatarëve me të cilët provoi qelitë e burgjeve të italianëve dhe të djalit të saj Feinit, jo vetëm u la në harresë e askush nuk e përmendi qoftë edhe njëherë, por edhe u tjetërsua. I vetmi që hodhi dritë ishte Hasan Shamo Meçaj në fillim të viteve shtatëdhjetë të shekullit që lamë, pasi në shënimet e tij historike, botuar në gazetën Kallarati, flitet për këtë ngjarje. Dudi Stratja mbetet simbol i “Nuses me flamur”, i nënës që rriti patriotë, i gruas që nuk u ligështua e gjunjëzua nga burgjet e pushtuesit të huaj. Ajo mbetet gruaja e vetme kallaratase, por edhe më gjerë, që ngriti lart vlerat e flamurit të lirisë e pavarësisë.

“LUMI I VLORËS, KY DET PASURISH KOMBËTARE”

Artikulli i Zeno Jahajt, “Lumi i Vlorës, ky det pasurish kombëtare”, botuar në gazetën Panorama, i kushton një rëndësi të veçantë krahinës së Lumit të Vlorës si një thesar natyror, historik dhe kulturor. Një pjesë domethënëse e këtij shkrimi përqendrohet në rëndësinë historike të fshatit Kallarat, të cilin autori e përshkruan si një “qytetërim brilant” dhe një “kujtesë unike në historinë kombëtare”.

Në një ton qortues dhe reflektues, Jahaj

shpreh shqetësimin për mungesën e vëmendjes institucionale ndaj këtij vendi të djegur dhe të braktisur nga koha. Ai thekson:

“Shpresoj të mos jetë e vërtetë që asnjë shtetar shqiptar, madje asnjë institucion serioz kulture, nuk ka shkuar të vizitojë ‘Kallaratit e Djegur’ – një qytetërim brilant, po aq një kujtesë unike në historinë tonë kombëtare, që na kujton se çfarë barbarish mund të sjellin ethet e shovinizmit të çdo kohe e nga kudo që të vijnë.”

Sipas autorit, nëse shtetarët dhe institucionet

kulturore do t’i kishin dhënë vëmendjen e merituar këtij vendi, Kallaratit do të mund të ishte shpallur “Qytet Muzé”, duke shërbyer si një dëshmi e gjallë e pasurisë kulturore dhe historike të Shqipërisë. Thirrja e tij përmban një apel të fuqishëm për të rikthyer vëmendjen ndaj kësaj zone, duke e konsideruar ruajtjen dhe promovimin e Kallaratit si një detyrë kombëtare për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Ky mesazh rezonon me rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kombëtare dhe ofron një per-

spektivë të thellë mbi pasojat e neglizhencës së gjatë ndaj zonave që mbartin një histori të pasur, por shpesh të harruar.

Ky shkrim i ushtarakut të lartë Zeno Jahaj, nga Mesapliku, i cili e ka parë nga afër “Fshatin e Djegur”, është një kampanë alarmi për ne kallarratasit, që jemi shumë të vonuar në kërkesën për shpalljen e “Fshatit të Djegur” si një Qendër Historike dhe Muzeale.

Redaksia



NGA ZENO JAHAJ ISH USHTARAK, STUDIUES, MIK I KALLARATIT

LUMI I VLORËS, KY DET PASURISH KOMBËTARE



të mos e shihte Krahinën?!

I Urti i Madh kishte parë botë. E ku nuk kishte shkuar: me anije a mjet tjetër ishte nisur nga Vlora dhe kishte parë Selanikun, Konjën e Stambollin, Janinën e Athinën, Varnën e Danubin, Bejrutin e Gjiritin, Napolin e Romën, Lozanën dhe Brukselin, Bukureshtin, Budapestin e Vienën. Kishte parë Beratin e Durrësin, por këtu, në Vlorë e në Mesaplik, e prunë me kal.

Kishte shërbyer në Egjipt, bash kur sapo ishte hapur Kanali i Suezit - arteria gjigante vertikale mu në zemër të kontinenteve e të tregtisë botërore. Me siguri do ketë përfytyruar se edhe Shqipëria Kombëtare nuk do zhvillohej pa ateriet vertikale, pa “kontinentin” e saj.

Çdo kohë e di se Krahina e Mesaplikut, apo shprehur figurativisht “thellësia kontinentale” e Vlorës, ka kapacitet për të mbajtur mbi 100.000 kokë bagëti të imta – një burim gjigant mirëqenie e tregëtie. Por sot, pra 100 e ca vjet më pas, si për

Vlora - kryeqyteti i parë i shtetit modern shqiptar, ia dedikon këtë po aq nyjes që lidh Detin Adriatik me Detin Jon, fortifikuar nga natyra, sa edhe Detit të Madh Kombëtar që vërshoi në atë qytet të bekuar më 28 Nëntor 1912, fortifikuar më së shumti nga halli se mos Shqipëria Kombëtare do të mbetej si një provincë Otomane, e kështu, jashtë Evropës.

I Urti i Madh, Ismail Qemal Vlora, Apostulli i Shqipëtarizms, nuk pati dot as kohën, as financat, as ushtrinë, as mbështetjen e duhur për të shkuar në të gjitha trojet shqiptare, ku do të mund të kumtonte atë Ditë të Madhe.

Madje i vunë gurë në rrota dhe i ngritën kurthe që të mos shkonte.

Gjithsesi, i Urti i Madh do të gjente fuqi për të kumtuar Ditën e Madhe në Krahinën e Lumit të Vlorës, e kështu në tërë Labërinë, mburojën dhe mbështetjen e afërt e të çeliktë të Pavarësisë: shkoi vetë në Mesaplik, mëse dy herë, si për ta ngjizur bekimin e atyre anëve.

Thonë, madje, se u kishte bërë një pyetje disi të çuditshme kapedanëve të Lumit:

“Sa larg është Deti nga Lumi i Vlorës? Sa i gjerë është këmbëmal i Vranisht - Himarë?”

“Dymijë manxerë” – i qenë përgjigjur kapedanët e asaj ane. Domethënë 2.500 metra, se ashtu flitej në atë kohë: ishin kohë të nxehta lufte dhe pushka “Mauser” ishte po aq metër kuvendi, sa “Kallashnikov” i kohëve më të vona.

Kushedi çfarë do të ketë patur parasysh i Urti i Madh me këtë pyetje, por një gjë ishte e ditur: Bregdeti dhe Lumi i Vlorës, thellë-thellë, këndojnë njësoj, qajnë njësoj e ndjejnë njësoj, sepse “Në Drashovicë e lart, Himarë i thonë çdo fshat”.

E pra, a nuk ishte një lloj mallkimi që, Krahina e Lumit të Vlorës, përfaqe mali me Bregdetin, të mbetej e dënuar të mos e shihte Detin dhe as Deti

ironi, ky burim është “tharë” për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore dhe për mëkat të atyre që nuk e kuptojnë e ca më shumë për mëkat të atyre që nuk duan ta kuptojnë: e tërë Krahina mbarështron vetëm 9.000 kokë bagëti të imta, dhjetë herë më pak nga kapaciteti natyror i saj!

E harkuar nga male 1.500-2.000 metra të larta, Krahina ka një kapacitet akoma më të madh natyror, ndoshta unik në shkallë kombëtare e më gjerë: të gjitha ujërat që rrjedhin nëpër Luginë e që mbushin dy lumenjtë e njohur malorë, Shushicën dhe Lumin e Smokthinës, janë të pijshëm. Nuk është herët të kuptohet se luftërat e ardhshme, më shumë sesa për mineralet e rralla, do të bëhet për ujë e pijshëm. Dhe konfliktet kanë filluar!

Ndërkohë, tre janë korridoret e tjera që i shumëfishojnë vlerën Lumit të Vlorës: Njëri kalon nga Qafa e Shëngjergjit dhe lidh Luginën e Lumit të Vlorës me kompleksin unik gjeografik Dukat – Tragjas – Radhimë – Llogora – Orikum – Karaburun, nga ku mbahet nën kontroll titulli i Shqipërisë si vend strategjik. Tjetri kalon nga Gryka e Vërmikut dhe lidh këtë Luginë me zemrën e Kurveleshit të sipërm - një kështjellë natyrore grykash që i bëjnë roje Vjosës, domethënë Parkut të parë Kombëtar të të vetmit Lumë të Egër të





mbrojtur në Evropë.

I treti, që lidh Grykën e Kuçit me kompleksin po aq unik gjeografik Pilur, Çorraj – Fterrë – Kudhës – Borsh, unik edhe ai, teksa përbën nyjen që bashkon Bregdetin me “thellësinë kontinentale”, domethënë me Lumin e Vlorës.

Një bllok i tërë, që ia kalon, ndoshta edhe Zvicrës, e cila, shumë-shumë iu gëzohet liqeneve e maleve, por asnjë deti!



Një bllok i tërë ku këndojnë njësoj, qajnë njësoj e ndjejnë njësoj: një det pasurish kombëtare.

Madje edhe një muzeum i madh kombëtar!

“Shpella e Shkruar” në Lepenicë, me 19 figura portret njeriu dhe 8 piktura gjeometrike, me vizatime në tavan, jo në mure siç rëndom gjënden në të tilla raste, është, alfabeti apo libri i llogarive i 5.000 viteve më parë, një dëshmi autentike e historisë, autoktonisë, identitetit, qytetërimit dhe

kulturës sonë kombëtare! (Dikush duhet të jetë i verbuar nga këto fakte, teksa kanë vënë njerëz për ta zhgarravitur tavanin e shkruar, me qëllimin e errët për t’i prishur origjinalitetin. Pa të dytë si e tillë në Ballkan, e rrallë në Evropë, Shpella e Shkruar ka shqetësuar më shumë institucionet spanjolle, sesa institutet kombëtare shqiptare të kulturës!

Të dashur historianë e arkeologë, shkruajeni me shkronja ari: Bazilika dhe Mozaiku i Mesap-

“Sa larg është Deti nga Lumi i Vlorës? Sa i gjerë është këmbëmali Vranisht - Himarë?”

“Dymijë manxerë” – i qenë përgjigjur kapedanët e asaj ane. Domethënë 2.500 metra, se ashtu flitej në atë kohë: ishin kohë të nxehta lufte dhe pushka “Mauser” ishte po aq metër kuvendi, sa “Kallashnikovi” i kohëve më të vona.

likut, të kohës paleokristiane, nuk do mund të ndërtoheshin vetëm në një djep civilizimi, jo në ndonjë shkretinë. Të shkruara në të dy alfabetet e dy civilizimeve të njohura të asaj kohe, fqinjëve grekë dhe romakë (pak a shumë siç kombet e botës moderne prezantohen sot vetëm në gjuhët anglisht e frëngjisht), bazilika e mozaiku kanë bartësit e vet autoktonë, shqiptarët, apo para-shqiptarët. Për më tepër që, edhe përmbajtja e shkrimit mbi Mozaik është pastërtisht shprehja ndoshta më e dhimbshme ku ka kaluar mbi-jetesa shqiptare: një komb i vuajtur, rron me pak, por jeton, mbijeton, sepse gjithnjë ka, e kështu mbetet i pakonkurueshëm në trojet e veta.

Shpresoj të mos jetë e vërtetë që copëzat e thyera të Bazilikës dhe të Mozaikut janë hedhur në ndonjë depo hedhurinash në Vlorë, në vend se i gjithë kompleksi të rindërtohej dhe të ruhej në vendin ku u gjet, siç bëjnë të gjithë kombet e kulturuar!

Shpresoj të mos jetë e vërtetë që asnjë shtetar shqiptar, madje asnjë institucion serioz kulture nuk ka shkuar të vizitojë “Kallarat in e Djegur” – një qytetërim brilant, po aq një kujtesë unike në historinë tonë kombëtare, që na kujton se çfarë barbarish mund të sjellin ethet e shovinizmit të çdo kohe e ngado që të vijnë. Harrojmë se industrinë e turizmit e zhvillojnë “qytetet e vdekura” si “Kallarati i Djegur”, barabartë me pak të tillë në botë.

“Në Qafë të Koçiut e lart, duhen dekoruar edhe gurët” – i mëshonte babai im këtij qortimi sa herë takohej me autoritete shtetërore të asaj kohe. E lanë pas dore Krahinën, pikërisht Lumin e Vlorës, i cili mobilizoi forcën e një armate popullore në Luftën Kombëtare të Vlorës të vitit 1920 dhe në atë të çlirimit nga fashizmi e nazizmi, kur, ndoshta çdo shtëpi, e ka paguar lirinë me të paktën një dëshmor.

Një qeverisje e tërë shpërfillëse “demokratike” e pas vitit 1990 e la Krahinën pas dore, për t’u kujtuar, së paku, në 5-6 vjetët e fundit ku, jo vetëm banorët, por të gjithë bashkëkombësit, madje edhe të huaj, kanë filluar t’i gëzohen kësaj arterie alpeze në rrugën e saposhtruar bukur me një projekt nga Kuvajti i largët.

Gjithsesi, fshatrat kanë mbetur po ata: trishtues, të varfër, të braktisur, e madje dyshues, deri sa, para pak kohësh, për inat të vjehrrës që i ka lënë pasdore, votuan edhe për mullixhinë!

Çfarë ëndërrojnë vallë ata që kanë mbetur në Velçë, Bashaj, Ramicë, Vërmik, Mesaplik, Bolenë, Vranisht a Tërbaç për të rindërtuar jetën në këtë vend përrallor, por të braktisur? Nuk shkojnë dot në dasma, apo varrime, nuk venë dot të vënë një tufë lule te varret e të parëve. Pesë në gjashtë bija e bija të Krahinës janë migruar, emigruar apo imigruar brenda e jashtë vendit! U qan syri për t’u kthyer e për ta bërë vendlindjen e tyre të rilindë, por pyesin (kë pyesin?!): “Çfarë do të bëhet me këtë Krahinë, për të cilën shtetarët kujtohen vetëm një herë në pesë vjet?”

Vlora - kryeqyteti i parë i shtetit modern shqiptar, me shumë mundësi, po bëhet dhe do të mbetet kryeqyteti i përhershëm edhe i turizmit në Shqipëri. Por pa Lumin e Vlorës, pa këtë det resursesh natyrore të mahnitshme, mund ta lëshojë shpejt këtë fron!



NGA BESNIK GJONBRATAJ

Mikpritja si virtyt njerëzor

Mikpritja është një ndër virtytet më të çmuara të njerëzimit, e rrënjësuar thellë në traditat e shumë popujve dhe e ushqyer nga ndjenjat e dashamirësisë, respektit dhe solidaritetit. Ajo shpreh aftësinë për të hapur dyert e shtëpisë dhe të zemrës ndaj të tjerëve, qofshin të njohur apo të panjohur, dhe për të krijuar ndjesinë e përkatësisë dhe ngrohtësisë njerëzore.

Në kulturën shqiptare, mikpritja ka qenë gjithmonë një gur themeli i identitetit kombëtar. Një vizitor në shtëpi konsiderohej si bekim dhe nder. Tradita thotë se “Shtëpia është e Zotit dhe e mikut”, duke treguar përkushtimin për të ofruar strehë, ushqim dhe siguri për këdo që troket në derë. Kjo frymë solidariteti dhe ndihme është një trashëgimi që shqiptarët e kanë ruajtur me krenari brez pas brezi.

Mikpritja nuk kufizohet vetëm në pritjen fizike të një njeriu, por përfshin gjithashtu mënyrën se si ne komunikojmë, kujdesemi dhe respektojmë të tjerët. Një buzëqeshje, një fjalë e ngrohtë, apo një veprim i vogël mirëkuptimi mund të përkufizojnë mikpritjen në situata të ndryshme të jetës.

Në një botë gjithnjë e më shumë të ndarë dhe të nxituar, mikpritja mbetet një vlerë që na kujton se, përtej dallimeve, të gjithë jemi pjesë e një bashkësie të përbashkët njerëzore. Të jesh mikpritës do të thotë të jesh i hapur për të pranuar të tjerët ashtu siç janë, duke krijuar ura bashkëpunimi dhe mirëkuptimi.

Përmes mikpritjes, ne kultivojmë jo vetëm marrëdhënie të shëndetshme, por edhe një botë më të drejtë dhe më të ngrohtë për të gjithë.

Mikpritja nuk kërkon patjetër pasuri apo fuqi materiale, ajo buron nga zemra dhe dëshira për të ndarë një copëz mirësi me të tjerët. Në fund të fundit, ajo që ne i japim mikut është një investim në ndërveprimin njerëzor, duke e bërë botën një vend më të ngrohtë dhe më të dashur për të gjithë.

Në pritje të trenit të fundit

Shkak për këtë shkrim u bë një bisedë e zakonshme me një bashkëfshatarin tim gjatë një ceremonie funerali, ku po flisnim dhe vinim në dukje vlerat pozitive të njerëzve që largohen nga jeta, midis tyre edhe për rastin në fjalë, nënën e tij, një bijë kallaratase që largohej nga kjo jetë duke lënë pas shumë kujtime dhe shumë vlera pozitive, për një nënë që do të mbahet mend, jo vetëm për dashurinë dhe përkushtimin ndaj familjes, por edhe për shpirtin e saj bujar dhe mikpritës.

Bashkëbiseduesi midis të tjerash u shpreh: “Nëna jonë, që po përcjellim sot, ashtu si edhe babai ynë, nuk flinin kurrë par orës 23 të mbrëmjes ose më saktë pa ardhur treni i fundit nga Tirana. Dhe e di pse më tha? Sepse mund të ndodhte që ndonjë bashkëfshatarë yni, ndoshta nuk gjente dot biletë për në Vlorë dhe do të kthehej te ne për të fjetur”. Dhe në jo pak raste kështu ndodhte me të vërtetë.

Më bëri shumë përshtypje një fakt dhe realitet i tillë, të cilin e kam jetuar edhe vetë. Në atë çast mendova se sa nëna dhe baballarë të tillë ka pasur në qytete si: Tirana, Vlora apo Fieri, ku bashkëfshatarët tanë lëviznin shpesh për punë apo halle familjare? Sa herë janë hapur dyert e shtëpive shqiptare për të pritur një mik, një të afërm apo edhe një të panjohur? Sa herë ka mbizotëruar fryma e mikpritjes dhe dashurisë ndaj tjetrit, pavarësisht kushteve të jetesës? Me siguri boll.

MIKPRITJA KALLARATASE NJË THESAR BREZASH

Ky detaj, i thjeshtë në pamje të parë, më bëri të ndalesha dhe të reflektoja. Një gjest i tillë flet shumë për zemërgjerësinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë që këta njerëz ndjenin ndaj bashkëfshatarëve të tyre. Ata, edhe pse mund të mos kishin shumë pasuri materiale, por kishin një pasuri shpirtërore të pashtershme: solidaritetin, dashurinë, respektin për njeri - tjetrin dhe dëshirën për të mos lënë askënd jashtë në kohë nevojë.

Ky realitet është një pjesë e rëndësishme e identitetit tonë kombëtar, një vlerë që duhet të ruajmë dhe ta përcjellim brez pas brezi. Nëna kallaratase - për të cilën po flisnim, nuk ishte thjesht një individ - ajo përfaqësonte një brez të tërë njerëzish të cilët jetonin me mendimin se një shtëpi nuk është kurrë vetëm për familjen, por edhe për ata që kanë nevojë. Dhe pikërisht kjo ndjenjë solidariteti dhe mikpritjeje e bën kulturën tonë kaq të veçantë dhe të vlefshme.

Të kujtosh dhe të nderosh njerëz të tillë është një akt detyrimi moral. Është një mënyrë për të thënë se vlerat e tyre nuk do të harrohen, se ato janë shembuj që na ndriçojnë rrugën, duke na kujtuar se humanizmi dhe kujdesi për tjetrin janë gurët themelorë të shoqërisë sonë.

Mikpritja e kallarataseve me banim në qytet

Sa e sa familje kallaratase në Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Sarandë, Tepelenë, Elbasan, Burrel dhe në qytete të tjera të Shqipërisë e kanë mbajtur gjithmonë hapur derën për çdo kallaratase që rruga, halli, fatkeqësia, gëzimi, apo rasti, për mungesë hoteli, apo mjetesh transporti, i kishte çuar drejt tyre? Në çdo orë të ditës apo të natës, trokitja në derën e tyre shoqërohej gjithmonë me një buzëqeshje mirëseardhjeje dhe me një përqafim të ngrohtë. Një filxhan kafe, një raki, një vakt bukë, një bisedë zemre dhe një vend për të fjetur, do të ishin të garantuara për këdo që vinte nga Kallarati, si shenjë e lidhjes së fortë që bashkëfshatarët ndjenin mes njëri-tjetrit.

Shpesh, edhe kur familjet qytetare kallaratase nuk kishin për të ngrënë për fëmijët e tyre, për të afërmit, për mikun e bashkëfshatarët nga Kallarati do të gjendej diçka. Qoftë një copë bukë, një çikë

djathë, një kokërr domate apo një qepë, sipas rastit dhe nivelit të familjes, në shumicën e rasteve edhe një darkë normale, pse jo edhe një darkë e veçantë për mikun, gjithçka do të shtrohej në tavolinën e ngrënies. Por, më e rëndësishmja, ishte mikpritja, shpirtmadhësia dhe dashuria e përmbledhur në shprehjen “bukë e kripë e zemër.”

Edhe për të fjetur, nëse shtëpia nuk kishte hapësirë të mjaftueshme, mikut do t’i gjendej gjithmonë vendi. Madje, ndonjëherë fëmijët e familjes flinin bashkë në një krevat apo edhe përdhe, vetëm që miku të ndihej i nderuar. Zakoni dhe nderi e donin që miku të pritej në mënyrën më të mirë të mundshme, një traditë që më shumë se detyrim, ishte nderim për vlerat dhe kulturën që kallaratasi e kishin mbajtur gjallë ndër shekuj.

Ky cikël dashurie dhe mikpritjeje ka mbajtur gjallë frymën kallaratase ndër shekuj. Ajo është dëshmi e një shpirti të fortë bashkëpunues dhe solidar, që u trashëgohet brezave me krenari. Mikpritja dhe dashuria, si dy vlera të pandashme, na kujtojnë se janë pikërisht këto virtyte që i mbajnë njerëzit dhe komunitetet të bashkuar. Ato meritojnë të shpërblehen vetëm me të njëjtën ngrohtësi, duke na kujtuar se çka japim është gjithmonë ajo që marrim.

Mikpritja e kallarataseve me banim në fshat

Ashtu siç kallaratasi që banonin në qytete të ndryshme të Shqipërisë prisnin e përcillnin me dashuri e respekt bashkëfshatarët e tyre, edhe kallaratasi që jetonin në fshat e ushtronin me përkushtim këtë traditë të vyer. Ishte një virtyt që buronte nga zemra dhe një ndjenjë përgjegjësie për tjetrin, një lidhje që kalonte kufijtë e kohës dhe hapësirës. Nuk kishte rëndësi ora apo situata, dera e çdo shtëpie ishte gjithmonë e hapur për ata që trokisnin, qofshin të afërm, miq, apo edhe të panjohur.

Gjatë verës, fshati gjallërohej nga zërat e fëmijëve kallaratase që vinin për pushime nga qytetet, ku banonin, kryesisht nga Vlora, Fieri, Durrësi e Tirana. Për ta, Kallarati ishte jo vetëm vendi i origjinës, por edhe një shkollë e jetës. Çdo ditë ata e kalonin me kushërinjtë e tyre, bashkë shkonin me bagëti, laheshin në lum, luanin me top dhe

çdo gjë tjetër që bënin fëmijët e fshatit. Një gjë e tillë i bënte më të shkathët, më të zhdërvjelltë dhe më të fortë për të përballuar vështirësitë e jetës në rritje. E gjithë kjo përvojë e fshatit ishte një aventurë e papërsëritshme dhe një mundësi për të forcuar lidhjet familjare e shoqërore.

Kur vinte momenti i largimit, ardhja e prindërve për ti marrë, ndërthurej me trishtimin e lamtumirës. Prindërit, edhe pse të lodhur nga udhëtimi, qëndronin një natë ose më shumë, dhe mikpritja kallaratase nuk zhgënjente kurrë. Një keq ose një shleg do të therrë patjetër për nder të tyre. Tryeza mbushej me ç’të mundte familja, pavarësisht varfërisë së kohës. Ishte një mënyrë për t’i kthyer mikpritjen që kishin marrë më parë në qytet.

Të nesërmen, kur miqtë dhe të afërmit largoheshin, nënat do t’u jepnin me vete disa nga prodhimet e fshatit: pak miell misri, çaj mali, rigon, gjalpë, ndonjë shishe dhallë ose qumësht, dhe gjithmonë ndonjë shishe raki, simbol i respektit dhe bujarisë. Ky akt i thjeshtë, por plot kuptim, nuk ishte thjesht një dhuratë, ishte një shprehje e dashurisë dhe kujdesit që përcillej nga brezi në brez.

Fëmijët largoheshin duke marrë pas shumë mbresa nga jeta në fshat. Ata largoheshin për të marrë masat për fillimin e vitit të ri shkollor, duke menduar kthimin përsëri në fshat vitin tjetër më të rritur në moshë e më të pjekur.

Përveç pritjes me dashuri të të afërmeve të tyre me banim në qytet, shumë nga familjet kallaratase deri vitet e fundit do të prisnin po me bujari edhe të deleguarit që vinin në atë kohë nga qyteti për problemet e partisë, të pushtetit, të arsimit e kulturës, të bujqësisë, blegtorisë, etj. Po me të njëjtën dashuri pritëshin edhe miqtë apo kalimtarë të ndryshëm të fshatrave fqinjë. Familjet kallaratase, brenda varfërisë që përjetonin, do t’i prisnin me çfarë të kishin, por gjithmonë për mikun e mysafirin do të gjendej dika më shumë se për fëmijët, por edhe për të afërmit.

Ta ruajmë dhe trashëgojmë traditën e mikpritjes edhe në kohën e sotme.

Kjo traditë e mikpritjes vazhdon edhe sot, ndoshta jo me të njëjtën formë, por me të njëjtën shpirt. Edhe pse sot koha ka ndryshuar, kjo traditë e mikpritjes vijon të mbetet e gjallë, ndoshta jo në ato përmasa. Në çdo fshat e qytet, njerëzit kujtojnë me krenari virtytet e paraardhësve dhe përpiqen t’i ruajnë ato si një pasuri të çmuar shpirtërore. Mikpritja, dashuria dhe respekti nuk maten me vlerën materiale të asaj që ofron, por me singëritetin dhe ngrohtësinë me të cilën pritet dhe përcillet miku.

Ky virtyt nuk është thjesht një zakon, por një pjesë e identitetit tonë kombëtar. Ai na kujton se, edhe në kohë të vështira, shpirtgjerësia dhe solidariteti janë ato që na bëjnë të veçantë dhe na japin forcë për të ecur përpara. Kallarati, me historinë dhe traditat e tij, mbetet një shembull i gjallë i kësaj trashëgimie të vyer, e cila duhet të ruhet dhe të përcillet tek brezat që vijnë. Rasti i pritjes së miqve nga Kosova e Tirana në “Takimin e Brezave” në Kallarat në gusht të këtij viti, ishte shembulli më i mirë i vazhdimësisë së mikpritjes kallaratase.

Ajo që ka rëndësi, nuk është vetëm bujaria materiale, por gjesti dhe ndjenja që qëndron pas saj. Në një botë që ndryshon me shpejtësi, është e rëndësishme të ruajmë këto vlera që na bëjnë të ndjehemi të lidhur dhe njerëzorë. Mikpritja dhe respekti janë virtyte që nuk njohin varfëri apo pasuri, por i japin kuptim jetës dhe marrëdhënieve tona.

Mikpritjen dhe dashurinë për njerëzit e trashëguam nga prindërit tanë. Duke i kujtuar ata me krenari, ndonjëherë pyesim veten: Si mund të rikthejmë një pjesë të asaj ngrohtësie njerëzore që humbëm gjatë rrugës vitet e fundit?



1 Mars 2025

NISMA “MBILL EDHE TI NJË PEMË NË VENDLINDJE”

THIRRJE: MË 1MARS TAKOHEMI NË KALLARAT

PEMA ËSHTË JETË! MBILLE EDHE TI NJË PEMË!

*1 mars 2025 – “DITA E PYLLËZIMIT” NË KALLARAT**Mbjellje pemësh dhe lulesh në hapësirat rreth Lapidarit dhe përgjatë përroit të Morrezës. Bashkohu me ne për të gjelbëruar vendlindjen! Le të mbjellim pemë dhe lule për një mjedis më të bukur dhe më të shëndetshëm!**Një pemë sot, një jetë më e mirë nesër!**Le të lëmë një gjurmë të gjelbër për brezat që vijnë!*

Takohemi në Kallarat

KUJTESË, HISTORI
QË PËRSËRITET

“Rapi i Mirit” - Një gjest që duhet përsëritur. Nga takimi i brezave më 21 gusht 2011 (Botuar në gazetën Kallarati nr. 58, viti 2011)

Besoje se të gjithëve ju kujtohet rrap dhe çezma e punuar me mozaik në anën e djathtë pranë lapidarit në Morrez. Natyra bëri të vetën dhe rrap u tha. Por kush ishte në festë, pa që në vend të tij ishte mbjellë një tjetër rrap i vogël që me siguri do të rritet e do të zëvendësojë të parin. Këtë gjest mirëbërës e bëri djali i fshatit tonë, Miri Azbi Ribaj, i cili si gjithmonë edhe kësaj radhe bëri diçka për fshatin e tij. Nuk ka rëndësi kostoja e harxhuar por veprimi i bërë, që rrallë kush mund ta kishte bërë. Të investosh sot për gjelbërimin në qendër të fshatit, veç të tjerave, është edhe mirënjohje e patriotizëm. Prandaj ky njeri duhet përgëzuar nga të gjithë kallaratasit. Rrap i mbjellë prej tij kërkon kujdes nga të tjerët se me siguri pas disa vitesh ai do të rritet dhe do të bëjë hije për t’u mbledhë e pirë një gotë uji pranë tij. Këtë rrap le ta pagëzojmë me emrin “Rapi i Mirit”. Gjesti i tij fisnik le të shërbejë edhe për biznesmenët e tjerë dhe këdo kallaratas. Çdo gjë, sado e vogël, që bën për vendlindjen tënde, duhet përgëzuar e falënderuar - përfundon shkrimi në gazetën Kallarati, viti 2011, përgatitur nga Besnik Gjonbrataj

Historia e mbjelljeve të rrepeve do të përsëritet më 1 mars 2025 në kuadrin e nismës “ Mbill edhe ti një pemë ose lule në vendlindje”

NISMËS “MBILL EDHE TI NJË PEMË
OSE LULE NË VENDLIDJE” PO I
BASHKOHEN SHUMË KALLARATAS

Kallaratas me banim brenda dhe jashtë vendit po i bashkohen nismës sonë për mbjelljen e pemëve dhe luleve në vendlindje, në qendër të fshatit, pranë Lapidarit. Kjo dëshirë për t’i dhënë jetë dhe bukuri më të madhe Kallarati tregon dashurinë dhe përkushtimin për fshatin tonë të përbashkët. Qëllimi kryesor i nismës është: Mbjellja e pemëve dekorative dhe krijimi i lulishteve, duke respektuar një kombinim harmonik me mjedisin dhe objektet përreth. Për këtë arsye, është e rëndësishme që procesi të organizohet sipas një plani të menduar mirë. Kërkohet ndihma e një agronomi, arkitekti ose eksperti që mund të hartojë një skicë për vendosjen e pemëve dhe luleve. Kjo skicë do të jetë udhërrëfyese për pjesëmarrësit në këtë nismë. Në mungesë të një plani të tillë, sugjerohet që të bashkëpunohet me kryetarin e këshillit të fshatit dhe banorët vendas për të vendosur në mënyrë kolektive për vendet e përshtatshme të mbjelljes.



Vendet prioritare për mbjellje: Hapësirat rreth Lapidarit, përfshirë krijimin e lulishteve brenda dhe përreth mureve rrethuese. Anës përroit të Morrezës, që fillon nga klubi i Koços në drejtim të ish-Vatrës së Kulturës. Të dyja anët e përroit në krah të djathtë të Lapidarit. Vende të tjera ku pemët mund të kontribuojnë jo vetëm për zbulim, por edhe për hije gjatë verës. Pemët e rekomanduara: Dekorative: pishë, rrap, shëlg, blin. Frutore: nëse janë të përshtatshme për klimën dhe terrenin (ullinj, portokalle, limon, fik, dardhë)

Ruajtja e traditës dhe mirëmbajtja: Në të shkuarën, hapësirat rreth Lapidarit kanë qenë të mbushura me pemë dhe lule, duke i dhënë fshatit një pamje të gjelbër dhe mik-

pritëse. Le të punojmë së bashku për ta kthyer këtë traditë dhe për ta bërë Kallaratin më të bukur dhe tërheqës. Në të ardhmen, mund të konsiderohet edhe krijimi i një shërbimi mirëmbajtjeje, duke punësuar një banor vendas me një pagesë modeste, financuar nga kontributet e kallaratasve.

Thirrje për kontribut: Të gjithë janë të mirëpritur të japin ndihmesën e tyre. Edhe ata që janë jashtë vendit mund të kontribuojnë, duke porositur njerëzit e tyre të afërm në Kallarat ose Vlorë që të mbjellin pemën në emrin e tyre. Çdo pemë e mbjellë do të ketë të identifikuar emrin e personit që e ka mbjellë.

Sugjerime dhe ide: Presim sugjerime e ide të tjera nga agronomë kallaratas, arkitektë ose çdo person që mund të ofrojë ekspertizë, veçanërisht për llojet e bimëve që përshtaten më mirë me klimën dhe terrenin e Kallarati. Vendlindja është e të gjithëve!



RRAPI I FUSHËBARDHËS NË KALLARAT

Në kuadrin e nismës “Mbill edhe ti një pemë” në Kallarati, shoqata mike e Fushëbardhës, dhuron për mbjellje një pemë që propozon të quhet “Rrapi i Fushëbardhës”. Shoqata “Kallarati” shpreh mirënjohjen më të thellë për Shoqatën e Fushëbardhës, e cila, nëpërmjet kryetarit të saj z. Nexhip Onjea, bën të ditur se mbështet nismën tonë “Mbill edhe ti një pemë” dhe më 1 mars do të dhurojë një rrap për t’u mbjellë dhe dëshiron të quhet “Rrapi i Fushëbardhës”. Një gjest i tillë është një shenjë e bukur miqësie dhe solidariteti mes komuniteteve tona të dy fshatrave.

Kjo nuk është hera e parë që Fushëbardha dhe Kallarati si dy fshatra të Labërisë me histori, të traditë e zakone të njëjta gjendet pranë njëri - tjetrit. Kjo lidhje e fortë ndërmjet nesh është një vlerë që duhet ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi. Faleminderit për mbështetjen, dashamirësinë dhe përkushtimin tuaj!

**Me respekt dhe mirënjohje,
Shoqata Kallarati**



Në kuadrin e nismës “Mbill edhe ti një pemë” në Kallarati, shoqata mike e Fushëbardhës, dhuron për mbjellje një pemë që propozon të quhet “Rrapi i Fushëbardhës”. Shoqata “Kallarati” shpreh mirënjohjen më të thellë për Shoqatën e Fushëbardhës, e cila, nëpërmjet kryetarit të saj z. Nexhip Onjea, bën të ditur se mbështet nismën tonë “Mbill edhe ti një pemë” dhe më 1 Mars do të dhurojë një rrap për t’u mbjellë dhe dëshiron të quhet “Rrapi i Fushëbardhës”. Një gjest i tillë është një shenjë e bukur miqësie dhe solidariteti mes komuniteteve tona të dy fshatrave.

Kjo nuk është hera e parë që Fushëbardha dhe Kallarati si dy fshatra të Labërisë me histori, të traditë e zakone të njëjta gjendet pranë njëri - tjetrit. Kjo lidhje e fortë ndërmjet nesh është një vlerë që duhet ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi. Faleminderit për mbështetjen, dashamirësinë dhe përkushtimin tuaj!

*Me respekt dhe mirënjohje,
Shoqata Kallarati*

NISMA “MBILL EDHE TI NJË PEMË” I KALON KUFIJTË E KONTINENTIT

Nisma “Mbill edhe ti një pemë” prej kohësh ka tejkaluar kufijtë e fshatit dhe tashmë ka prekur edhe kontinente të tjera. Një shembull i bukur i kësaj shpirtmadhësie është kontributi i tre vëllezërve Rexhepaj nga Vranishti – Matjani, Araniti dhe Ligorin, të cilët, pavarësisht se jetojnë e punojnë larg, në Kanada, nuk e harrojnë as vendlindjen e tyre Vranishtin, por as fqinjësinë e hershme me Kallaratin.

Gjithçka nisi me një telefonatë nga larg. Matjan Rexhepaj më drejtohet me mirënjohje për nismën tonë për gjelbërimin e Kallaratis dhe më bën me dije se, bashkë me dy vëllezërit e tij, Arianitin dhe Ligorin dëshirojnë të dhurojnë tre rrepe për t’u mbjellë më 1 Mars në Kallarati. Për ta, kjo nuk është thjesht një mbjellje simbolike, por një akt dashurie ndaj tokës së të parëve dhe një dëshmi e lidhjeve të forta që nuk i ndan as koha, as largësia.

Në përpjekjen për t’iu shprehur mirënjohjen, i them se një pemë do të ishte e mjaftueshme, mjafton gjesti juaj fisnik. Por Matjani këmbëngul me një ndjesi të thellë përgjegjësie dhe përkatësie: “Ne jemi tre djem të Fiço Rexhepaj nga Vranishti që jetojmë e punojmë në Kanada dhe secili ka pjesën dhe dëshirën e vet”. Kjo këmbëngulje nuk është vetëm një shenjë bujarie, por edhe një mesazh i fuqishëm për të gjithë ata që, kudo në botë, e ndiejnë përgjegjësinë për ta bërë më të bukur e më të gjelbër vendlindjen.

Ndaj, si kryesi e shoqatës falënderojmë të tre vëllezërit Rexhepaj: Matjanin, Aranitin dhe Ligorin - tre djem të mrekullueshëm që e ruajnë me krenari trashëgiminë e tyre dhe i japin vlerë miqësisë e fqinjësisë së hershme mes Vranishtit dhe Kallaratis.

Urojmë që shembulli i tyre të frymëzojë të tjerë e të lërë gjurmë të gjelbra për brezat që do të vijnë!

RRAPI I MADH

Ky rrap i madh shekullor në foto nuk është i Kallaratis, por i Libohovës, një monument natyre i mbrojtur nga shteti.

Po në Kallarati, a kishim rrepe të tillë të mëdhenj e madhështorë? Patjetër që po! A ju kujtohet Rrapi i Madh të xhamia në Fshatin e



Djegur? Po ai te burimi i Morrezës dhe shumë të tjerë, me trungjet e tyre të fuqishëm, lartësinë madhështore dhe degët e degëzuara hijshëm? A i mbani mend rrepet përgjatë përroit të Morrezës dhe sidomos në të gjithë shtratin e lumit Shushica, nga Babëzotet në kufi me Vranishtin, deri te Shkëmbi i Bletës në kufi me Kuçin? Po shëlgjet? Sigurisht që po.

Ata ishin të lashtë, disa disavjeçarë, ndoshta edhe shekullorë. Por, fatkeqësisht, shumica u

zhdukën – disa nga dora e njeriut, të tjerë nga natyra, ndërsa sëmundja e viteve të fundit vulosi shfarosjen e tyre, jo vetëm në Kallarati, por në gjithë zonën dhe jo vetëm.

A është i nevojshëm përsëri gjelbërimi i zonës me rrepe e pemë të tjera? Sigurisht që po! Gjelbërimi është i domosdoshëm për bukurinë, hijen dhe oksigjenin që na fal. Po si mund ta rikthejmë atë? Duke mbjellë rrepe të rinj dhe pemë të tjera. Nëse kujdesemi për to, edhe pse brezi

ynë mund të mos i shohë të mëdhenj e hijerëndë si dikur, brezat e ardhshëm do t’i shijojnë dhe do të na falënderojnë.

Mbjellja dhe kujdesi për pemët duhet të kalojë si një stafetë nga brezi në brez! Prandaj, ejani më 1 mars në Kallarati dhe mbillni një rrap, një shëlg, a një lloj peme tjetër, që brezat e ardhshëm të thonë: “Faleminderit të parëve tanë që ditën ta gjelbërojnë e lulëzojnë Kallaratin!”



PROFESOR ARDIT BIDO I BASHKOHET NISMËS SONË

Shoqata “Kallarati” dhe të gjithë kallarasit shprehin mirënjohjen e tyre më të thellë për intelektualin e analistin e shquar, Profesor Dr. Asoc. Ardit Bido, jo vetëm për mbështetjen e tij të palëkundur ndaj çështjes mbarëkombëtare dhe kontributin e çmuar në njohjen e historisë së Kallaratit, në mënyrë të veçantë qëndresën e tij në vitin 1914, por edhe për këtë gjest simbolik dhe domethënës në kuadër të nismës “Mbill edhe ti një pemë”.

Dhurimi i një peme për Kallarat nuk është vetëm një akt në shërbim të natyrës, por edhe një shenjë respekti dhe mirënjohjeje për një vend që ka mbajtur peshën e historisë me krenari e dinjitet. Sikurse kallarasit nuk janë kursyer kurrë për atdheun, ashtu edhe ky akt i profesor Bidos vjen si një dëshmi tjetër e lidhjes së tij të sinqertë me këtë vend e me këtë histori, ku vitin e kaluar vizitoi dhe pa nga afër “Fshatin e Djegur” dhe ishte i pranishëm edhe në Takimin e Brezave.

Jemi krenarë për miq të tillë dhe e mirëpresim gjithmonë si një mik të nderuar në mesin tonë!



PISHA TË DURRËSIT NË KALLARAT

Një mirënjohje e veçantë për Gjergji Dautajn dhe djemtë e tij, Albanin e Geraldin, që edhe këtë vit i qëndruan pranë Kallaratit me dashuri e përkushtim. Pas kontributit të tyre vitin e kaluar për ndriçimin e qendrës së fshatit, tashmë kanë sjellë nga Durrësi edhe 15 fidanë pishash, të cilat në kuadrin e nismës “Mbill edhe ti një pemë në vendlindje” do të mbillen nën kujdesin e Arjanit Rjepaj në varrezat e fshatit, atje ku prehen të parët tanë. Faleminderit nipërve të Kallaratit që nuk e harrojnë vendlindjen e prindërve dhe gjyshërve të tyre! Faleminderit Arjanit Rjepaj!



1 MARS 2025

Sot në Kallarat në kurorëzimin e nismës “Mbill edhe ti një pemë në vendlindje”, midis shumë kontribuuesve dhe pjesëmarrësve edhe figura të shquara dhe dashamirëse të Kallaratit, intelektualit i shquar dhe mik i Kallaratit, Profesor Ardit Bidon, kryetari i shoqatës Labëria të Vlorës z. Ahmet Dema, poeti nga Mesapliku Namik Jahaj dhe shumë miq e dashamirës të Kallaratit.

Gratë e Kallaratit në mbështetje të nismës “Mbill edhe ti një pemë në vendlindje”. Faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin Tuaj!





FALËNDERIM PËR PJESËMARRRJEN NË NISMËN “MBILL EDHE TI NJË PEMË NË VENDLINDJE”

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” shpreh mirënjohjen e saj të thellë për të gjithë bashkëfshatarët, brenda dhe jashtë vendit, që u bënë pjesë e nismës “Mbill edhe ti një pemë në vendlindje”. Kjo iniciativë shkoi përtej kufijve të fshatit, duke gjetur përkrahje, jo vetëm nga ata që morën pjesë drejtpërdrejt në mbjellje, por edhe nga shumë miq e dashamirës që na mbështetën moralisht me mesazhet e tyre inkurajuese.

Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që kontribuan financiarisht duke mbjellë pemë, duke e kthyer këtë nismë në një shembull të bukur solidariteti dhe dashurie për vendlindjen. Me mirënjohje të veçantë përshëndesim shoqatën e Fushëbardhës e kryetarin e saj, poetin Nexhip Onjea, e cila gjithmonë na gjendet pranë në aktivitetet tona, si dhe intelektualin e shquar dhe mikun e Kallararit, Ardit Bido, i cili jo vetëm ka promovuar historinë e fshatit tonë, por edhe mbollti një pemë në emrin e tij si shenjë simbolike e kësaj lidhjeje të fortë. Falënderojmë tre vëllezërit nga Vranishti, djemtë e Fiqo Rexhepaj, Matjanin, Aranitin, Ligorin, te cilët nga Kanadaja morën pjesë në këtë nismë duke dhuruar në shenjë respekti e miqësisë si gjithë tre rrepe.

Gjithashtu falënderojmë kryetarin e shoqatës “Labëria”, dega Vlorë, z. Ahmet Demaj, poetin dhe mikun e Kallararit z. Namik Jahaj, të cilët në momentin e fundit iu bashkuan nismës tonë duke mbjellë një pemë në frymën e miqësisë, duke e quajtur “Pema e miqësisë”.

Një falënderim i veçantë i takon bashkëfshatarit tonë, z. Brahim Goxhaj, i cili u angazhua i pari në këtë nismë, duke u kujdesur për blerjen dhe transportimin falas të pemëve për në Kallarat.

Gjithashtu, falënderojmë znj. Elena Memushaj e kryetarin e fshatit z. Bashkim Davaci për mundësinë e sigurimit të mjetit për hapjen e gropave. Falënderojmë vetë Lili Memushajn për hapjen e gropave me skrep dhe anulimin e pjesëmarrjes në një sebp familjar.

Falënderojmë kryetarin e Njësinë Administrative Horë-Vranisht, z. Gramoz Balilaj, bashkinë e Himarës dhe vetë kryetarin e saj zotin Vangjel Tavo për përkrahjen dhe mbështetjen logjistike të nismës.

Mirënjohje për këshillin e fshatit dhe për të gjitha gratë e fshatit, të cilat u përfshinë me përkushtim në këtë nismë.

Përgëzojmë gjithashtu të gjithë ata që kontribuan financiarisht, kontributet e të cilëve i kemi bërë publike, individët të cilët u paraqitën me pemët e blera prej tyre dhe shumë të tjerë, të cilët punuan për mbjelljen e tyre brenda një kohe rekord.

E veçanta e kësaj nisme ishte se u mbollën edhe tre pemë në emër të shoqatës në kujtim të atyre të ndarë nga jeta: Në Morrez në kujtim të “Bilbilit të



Labërisë”, Hyso Xhaferaj, në kujtim të Dorit të sapo ndarë nga jeta, të Dorit që e deshi aq shumë Kallaratin dhe në Qafën e Ubavit në kujtim të Fiqirete Rjepaj ndarë nga jeta në mënyrë tragjike.

Ajo që ra në sy gjatë aksioni, ishte pjesëmarrja e gjerë e banorëve vendas, por edhe të ardhur nga Bolena, Vlora, Tirana, pavarësisht se kishin

kontribuar ose jo me pemë, u angazhuan në mbjelljen e pemëve, pa qenë nevoja e komandimit të tyre, pasi ata kush më shumë e kush me pak ishin aty ku duhej punë e ndihmë. Në këtë rast përmendja e emrave do të ishte e tepërt. Faleminderit të gjithëve. Falë të gjithëve, sot Kallarati është më i gjelbër dhe më i bukur. Pemët u mbollën, por kujdesi për to sapo ka

nisur. Ato duhet ruajtur, vaditur dhe mirëmbajtur, në mënyrë që të rriten dhe të bëhen simbol i një brezi që investon në të ardhmen e vendlindjes. Përveç kujdesit ndaj tyre në mënyrë vullnetare, kryetari i fshatit duhet të angazhojë individët e punësuar nga bashkia.

Faleminderit të gjithëve nga zemra!

Nisma vazhdon, sepse pema është jetë!





TRE PEMË QË PËRJETOJNË KUJTIMIN TË ATYRE TË NDARË NGA JETA

E veçanta e kësaj nisme ishte se u mbollën edhe tre pemë në emër të shoqatës në kujtim të atyre të ndarë nga jeta: Në Morrez në kujtim të “Bilbilit të Labërisë”, Hyso Xhaferaj, në kujtim të Dorit të sapo ndarë nga jeta, të Dorit që e deshi aq shumë Kallaratin dhe në Qafën e Ubavit në kujtim të Fiqirete Rjepaj ndarë nga jeta në mënyrë tragjike.

NISMA VAZHDON: EDHE NË QAFËN E UBAVIT MBILLEN PEMË

Fjalët janë të pakta për të përshkruar dashurinë dhe përkushtimin që bijtë e Kallaratis tregojnë për vendlindjen e tyre. Ajo që nisëm dje në zemër të fshatit, sot mori një tjetër kuptim të thellë në lagjen Qafa e Ubavit, ku Arjanit Rjepaj dhe bashkëfshatarët tanë u bënë shembull i vërtetë i mirënjohjes dhe respektit për të parët tanë.

Mbjellja e pemëve nuk është thjesht një veprim simbolik, por një premtim i gjelbër për të ardhmen dhe një dëshmi që kujtimi i atyre që nuk janë më do të jetojë përjetë në rrënjët dhe degët e së tashmes sonë.

Një falënderim nga zemra për Arjanitin dhe të gjithë ata që me mund, dashuri dhe përkushtim i dhanë jetë kësaj nisme fisnike.

Ky është Kallarat, fshati ynë i dashur, që rrit jo vetëm pemë, por edhe vlera të mëdha njerëzore!

Ky është Kallarat, fshati ynë i dashur, që rrit jo vetëm pemë, por edhe vlera të mëdha njerëzore!



TRANSPARENCË MBI MBËSHTETJEN FINANCIARE TË NISMËS “MBILL EDHE TI NJË PEMË NË VENDLINDJE”

Të gjitha të ardhurat e grumbulluara për këtë nismë, u bënë publike në fejsbukun e shoqatës, si dhe pemët e blera me çmimin përkatës. Faleminderit të gjithë atyre që kontribuan në këtë nismë, e cila do të përsëritet me siguri çdo vit.



DORJAN REFAT RJEPAJ, NJË SHEMBULL FRYMËZUES I PUNËS DHE PËRKUSHTIMIT


Kryesia e shoqatës “Kallarati” ndihet krenar me arritjet e Dorjan Rjepaj, djalin me origjinë nga Kallarati, i cili po çon përpara me sukses biznesin e krijuar nga i ati, Refat Rjepaj (ndarë nga jeta). Refati, dikur një blegtor i njohur në Kallarati, me shpërnguljen në Çukë të Sarandës në vitin 1992, iu përshtat ekonomisë private dhe me punë të palodhur, së bashku me familjen



e tij, ngriti një biznes të qëndrueshëm në blegtori dhe bujqësi.

Sot, Dorjani, së bashku me të vëllain Arbërin, është një emër i njohur në rrethin e Sarandës si një biznesmen i suksesshëm, duke e çuar përpara këtë traditë me vizion dhe përkushtim. Arritjet e tij në sektorin e blegtorisë dhe bujqësisë nuk janë vetëm një histori suksesi personal, por edhe një krenari për Kallaratin, duke dëshmuar se rrënjët dhe vlerat e vendlindjes janë një bazë e fortë për zhvillimin dhe përparimin.

Në emër të kryesisë së Shoqatës “Kallarati”, i urojmë Dorjanit suksese të mëtejshme në rrugën e tij në biznesin privat familjar! Qofshin puna dhe vizioni i tij një shembull për të gjithë ata që me mund dhe përkushtim ndërtojnë të ardhmen e tyre në Shqipëri!





Kjo botë shëmtohet sa herë pasuria bëhet qëllim në vetvete dhe e vret njeriun.
Autori

Unë jam njeri i thjeshtë, i zakonshëm
Dhe këndoj për vete, për njerëz si unë.
Por as shqisat, as shija s'më mungojnë
Për ta shijuar botën sa të mund.

Dhe s' më vjen turp, as ligështohem
Që s'kam të madhe pasuri
As prona, as vila në hipotekë
As kasaforta me flori.

Unë kam moralin ar mbi ar
Para tij shkëlqimi i arit zbehet
Dhe s'ka tiran e demagog
Që të më bëjë prapa të kthehem.

Dhe s'kam nevojë të kem sejmenë
Dhe oborrtarë plot intriga
Ku damat lyer e përlyer
Ngjajnë të gjitha mu si shtriga.

“KËNGA E NJERIUT TË NDERSHËM”,

poezi nga Petrit Qejvani (ndarë nga jeta)

Unë jam i ndershëm, ndaj dhe i pasur
Dhe mbret e bos s'më hyn në sy,
Se kurthe, servilë e prapaskena
I mbyt me një det me dashuri.

Dhe nuk shoh ëndrra me euro,
As me çeqe a me trafik.
Më mjaftojnë zemrat e miqve,
Që vlejnë më shumë se një çiftig.

Paçka se miqtë i kam të thjeshtë
Por shumë të pasur shpirtërisht,
Që kurrë s'më deshën për interes
Që kurrë s'më shitën tinëzisht.

-2.-

Unë asnjëherë nuk u përkula
Para zyrtarit ordiner.
S'u bëra qejfin asnjëherë
Dhe në s'më deshën, s'kam qeder.

Për mua është e rëndësishme
Në këtë botë të jesh njeri,
Paçka që s'ke një mal me pare
Paçka që s'je në qeveri.

Për mua bota s'është paraja
Dhe shpirti s'është një kartëmonedhë
Dhe dashuria njerëzore

Nuk është një mall në treg i blerë.

Se dashuria njerëzore
Me dashuri fitohet, po.
Dhe prostituta për ca pare
Trupin ta jep, por shpirtin jo.

Me pare mund të blesh ç'të duash
Vetura, rroba, vila, plazhe,
Po kurrë dashurinë e madhe,
Që s'blihet, veç vetëm falet.

Po vlerat di t'i respektoj mirë
Të kujtdo qofshin: mik, armik.
Përulem para gjerave të shenjta
Pa hezitim, me gjest fisnik.

E di që shumëkush do qeshë
Për çka them unë, për çka rrëfej,
Por jam i qetë dhe kaq i paqme,
Sa në Parajsë veten e gjej.

E di që në kohën e sotme
Asnjë dysh s'vlen ndershmëria,
Po bëj një gjumë kaq të qetë,
Sa ma ka zili dhe perëndia...

Sepse s'i bëra keq njeriu
As mashtrova, as urreva
Ndonëse të ligjtë i përbuza
Dhe shpinë të drejtës s'ia ktheva.

Unë e urrej hipokrizinë
Fytyrat- maska i urrej
Buzëqeshjen finoke pas shpine,
Shkeljen e syrit dhe... ok.

S'e kam zili unë babëzinë
Gobsekët e rinj që s'i zë gjumi,
Që përfitojnë nga trafiket,
Që pasurohen nga zullumi.

Që shesin me zarfa vende pune,
Që me tendera vënë miliona,
Që ngrenë vila mbi varfërinë,
Që zotërojnë gjithandej prona.

Që e shqyen copë Shqipërinë
Kush të marrë llokmën më të madhe
Dhe mbajnë fjalime mallëngjyese
Për dashurinë atdhetare!..

Këto s'i them se s'jam i pasur
Dhe respektoj në maksimum
Atë që fitohet me djersë
Atë që fitohet me mund.

Dhe himn i ngre punës së ndershme.
Mendjes së ndritur himn i ngre.
Por në pedestal, mbi të gjitha,
Ndershmërinë statujë e ve.

Petrit Qejvani, 2004-2008

KË DO TË ZGJIDHJE? RRËFENJË ARABE – SJELLË NË SHQIP NGA BAJRAM KARABOLLAJ



NGA BAJRAM KARABOLLI

Një grua, ndërsa po ujiste kopshtin e shtëpisë,
pa, mu përpara kopshtit, tre pleq me gjithë ato vite
përvojë. Ajo i pa me kureshtje këta të panjohur dhe
u tha:

- Unë nuk ju njoh, por duhet t' u ketë marrë uria.
- Ju lutem, ejani brenda që të hani diçka.
- Ata iu përgjigjën:
- A është yt shoq në shtëpi?
- Jo, nuk është, - u përgjigj gruaja.
- Atëherë, nuk mund të vijmë, - thanë ata.
- Pas nja dy orësh, kur mbërriti i shoqi, ajo i

- tregoi për pleqtë.
- Mirë atëherë, thuaju se erdha dhe ftoi të vijnë brenda, - i tha i shoqi.
 - Gruaja doli dhe i ftoi pleqtë e huaj të hynin në shtëpi.
 - Nuk mund të vijmë në shtëpi të tre bashkë, - thanë pleqtë.
 - Pse? – pyeti ajo.
 - Njëri nga ata tregoi me gisht shokët e tij duke thënë:
 - Ky është Pasuria, ky tjetri është Suksesi, ndërsa unë jam Dashuria. Tani shko brenda, këshillohu me tët shoq dhe vendosni se cilin nga ne të tre do të ftoni në shtëpi.
 - Hyri gruaja brenda dhe i tregoi të shoqit se çfarë i thanë ata. I shoqi, tepër i gëzuar, tha:
 - Oh, sa mirë! Meqenëse qenka kështu, le të ftojmë Pasurinë të hyjë brenda e të na begatojë shtëpinë.
 - E shoqja nuk ishte në një mendje me të:
 - I dashur, pse të mos ftojmë Suksesin?

- Bija e tyre, e cila i dëgjoi që nga qoshja tjetër e shtëpisë, erdhi me vrap dhe iu tha prindërve:
- Ju lutem, ftoni të hyjë Dashuria, se atëherë shtëpia jonë do të mbushet me dashuri.
 - Le të bëjmë siç thotë goca, - i tha i shoqi gruas. – Shko e fto Dashurinë të hyjë në shtëpi, si mysafiri ynë.
 - Gruaja doli dhe pyeti:
 - Ju lutem, le të hyjë në shtëpinë tonë si mysafir ai që quhet Dashuri.
 - Dashuria u ngrit dhe eci drejt shtëpisë. Pastaj u ngritën edhe dy të tjerët dhe shkuan pas tij. Gruaja, pak e habitur, iu drejtua këtyre dy të fundit:
 - Unë ftova vetëm Dashurinë, po...
 - Të moshuarit u përgjigjën njëherazi, të tre:
 - Nëse do të kishe ftuar Pasurinë apo Suksesin, dy të tjerët nuk do të hynin, por ti ftove Dashurinë. Ne të dy nuk ndahemi kurrë prej Dashurisë.
 - Aty ku ka dashuri, patjetër ka pasuri dhe sukses.



FOLKLOR, ART DHE HISTORI



NGA EDUARD DEMO,
ish-ushtarak, studiues, mik i Kallarazit

Kur dëgjon këngën Labe kënduar nga i Madhi Hysen Ruka, s'ke se si të mos mbash frymën e të përqendro-hesh për t'i shijuar në maksimum çastet e gëzuara që të dhuron. I gjithë grupi është në një harmoni të plotë zërash melodioz, pa asnjë stonaturë, me një ritëm të plotë, të saktë dhe të ëmbël duke i përmbledhur të gjitha notat e pentagramit. Të duket sikur një orkestër e madhe harqesh dhe veglash muzikore frymore dirigjohen me shumë saktësi nga artisti i mirën-johur Hysen Ruka. Ky bariton brilant, me zërin e tij të ëmbël, të pastër dhe të qartë, kumbon si jehonë e maleve cmokthinjote. Shoqëruar në ritëm e në kohë dhe ndërthurur me tenorë të shkëlqyer të grupit të cilët i këndojnë fjalët thellë e të plota, të japin ndjesinë e një kori madhështor, laureuar në Akademitë e Arteve më me emër të botës. Marrësi i këngës, dirigjenti Hysen Ruka, me virtuozytetin e tij, e shtrin vargun me shumë muzikalitet, duke i treguar hedhësit ose kthyesit të jetë i vëmendshëm për të mos humbur asnjë notë muzikore, si dhe grupit të gjerë të isos të jenë të gjithë në një tonalitet, pa rënduar harmoninë muzikore.

E duke e dëgjuar dhe shijuar çdo varg nuk mundet kurrsesi mos ta ndjesh thellësinë e vargjeve popullore, të cilat përmbledhin brenda tyre periudha të mëdha historike, prijësa të mëdhenj të Labërisë që kanë bërë Shqipërinë Shqipëri.

Ja si shprehet poeti ynë i madh Lasgush Poradeci për artin e bukur të të shkruarit, por edhe të të kënduarit

“Mallkuar qoftë jeta materiale që ndalon artin, gëzimprurësin e madh të njeriut - po i lavdëruar, lart dhe thellë dhe gjatë dhe gjerë dhe forcërisht dhe krejtësisht dhe përjetësisht i lavdëruar qoftë arti, i madhi gëzimprurës - i cili, shpirt prej shpirtit më të kulluar, formë prej formës më të purifikuar, e mposht dhe e mund materien duke u sakrifikuar.”

Poeti popull shkruan:

“Do qaj unë Labërinë,
Për Çelon që mbet n’Athinë,
Gjolek kordhë këqinë,
Bashkë me Hodo Alinë.
Njëri Rjekë tjetri Cetinjë,
Për të mbrojtur kufinë.
Ç’ke që qan moj Këndrevicë,
E larta mbi male gjithë?
Qaj për trimm e Shqipërisë,
I shkreti Hodo Nivicë,
Bën dyfek në Podgoricë,
Bam ja bëjnë e dot se vrisnë.
Plumbat mbi të s’kolisnë,
Rrobat e shkreta ja grisnë.”

Brenda katërmbëdhjetë vargjeve, poeti popull përmbledh heroizmin e shqiptarëve për të mbrojtur trojet e të parëve, kufijtë etnikë e



Ky bariton brilant, me zërin e tij të ëmbël, të pastër dhe të qartë, kumbon si jehonë e maleve cmokthinjote. Shoqëruar në ritëm e në kohë dhe ndërthurur me tenorë të shkëlqyer të grupit të cilët i këndojnë fjalët thellë e të plota, të japin ndjesinë e një kori madhështor, laureuar në Akademitë e Arteve më me emër të botës. Marrësi i këngës, dirigjenti Hysen Ruka, me virtuozytetin e tij, e shtrin vargun me shumë muzikalitet, duke i treguar hedhësit ose kthyesit të jetë i vëmendshëm për të mos humbur asnjë notë muzikore, si dhe grupit të gjerë të isos të jenë të gjithë në një tonalitet, pa rënduar harmoninë muzikore.

gjeografikë, pra përtej në Greqi, e akoma më tutje në Rijekë, por edhe Cetinja nuk është pranë Labërisë. Kjo këngë, krijuar në mesin e shekull XIX, para plot 170 vjetësh, u transmetua brez pas brezi deri sot në ditët tona, e pandryshueshme, e madhështore, si një jehonë mbushur me krenari. Ardhur sot në ditët tona, një margaritar i rrallë, gojë mbas goje, këngëtar mbas këngëtarësh, nga breza të tërë bash-

këqytetarësh, qindra vjet më parë të cilët kurrë nuk e kanë harruar, e nuk e harrojnë edhe sot në kohëra moderne. Kënga të bën t'i kthehesh për ta rilexuar, të fut në mendime e të mbush me krenari për të parët tanë. Ç’do varg edhe veçmas ta lexosh, është kuptimplotë në thellësi mendimi, madhështor, në harmoni fjalësh të gjetura të vendosura si megalite, të radhitura në mënyrë të përpiktë duke i treguar dëgjuesit

dhe lexuesit pavdekësinë e tij.

Vargu i parë si më poshtë:

“Do qaj unë Labërinë”

Çfarë nënkupton poeti me “unë” ?!

“Unë“ sinjifikon popullin, si një qenie frymore që vjen madhështor e i pambarimtë, i pavdekshëm në mijëra e mijëra vjet! Vazhdon dhe mbetet në përjetësi, e do të vijojë njësoj edhe kur brezat tanë që e dëgjojmë sot këngën, të mos jenë më. Sigurisht nuk është Zoti vetë, por pavdekësinë e ka fituar, dhe këtë të drejtë, as Zoti vetë nuk ja mohon dot. Vazhdon dhe përcjellë në breza jo vetëm me këngë por edhe me fjalë popullore. Miklon qysh me qumështin e nënave që kërthi në djep, në ninullat e përkundjeve dhe përkëdheljet e tyre. Ushqen breza në rini, në burrëri e në moshë madhore duke mos i lenë të humbasin, duke treguar me dashuri e vëmendje se si të duan atdheun.

Ndërkohë këngëtari i jep ngjyrat e duhura vargjeve, ëmbël dhe qartë, si një gurgullimë uji në një burim të kristaltë që nuk lejon asnjë ndotje, që pëlqehet deri në përjetësi e që nuk humbitet.

Labëria, në gjithë veprat e saj, përzgjedh, nuk gabon kurrë, nuk transmeton përcudnira, stonatura ose kotësi. Ajo përcjellë shembuj sinjifikativë, me vlera dhe virtyte të larta, si heroizmi dhe patriotizmi, hidhërimi dhe gëzimi, jete dhe vdekjeje.

Kurse Shqipëria është altari, që shpërfill e injoron mediokritetin, me veprime edhe me gjithçka. E përbuz atë me të gjithë shpurën e saj lapangjoze. Me të gjithë kopenë e tyre të zagarëve dhe langove të cilët turren të lëpijnë, në një zallamahi turbulluese, kockat ditore.

“Do qaj unë Labërinë“ përcillet në përmasa madhështore. Siç thotë i madhi Rexhep Qosja “ ...Labëria (ashtu siç e përjetova unë), është Shqipëria natyrore e kjo domethënë Shqipëria etnike... Në këngën Labe të djeshme dhe të sotme, jetojnë shqiptarët e të gjitha trojeve kombëtare shqiptare “.

Do t’ju tregoj “Unë” sepse..., do t’ju këndoj sepse..., do t’jua recitoj sepse... vetëm kështu mund të ruhen dhe përcillen mesazhet e rëndësishme. Jo me vaje arkmorti por me këngë të përjetshme, të papërsëritshme, të paharrueshme, të thella dhe të gjera, që ndihen deri në kockë. Jo me fjalë tmerri, por me fjalë burri kurajoz, me fjalë trimi dhe guximtari, me fjalë ati e me fjalë biri. Për të bërë këtë jam “Unë“, pra poeti, këngëtari popullor.

Më poshtë vazhdon:

*“Për Çelon që mbet n’Athinë,
Gjolek kordhë këqinë,
Bashkë me Hodo Alinë.”*

Emrat janë të përvetshëm, sepse kanë bërë historinë e Shqipërisë. Janë trimat e saj që kanë luftuar për të, kanë sakrifikuar edhe më sublimen. Sigurisht këta kapëdanë kanë nga poeti popull secili veçmas shumë e shumë këngë, shumë e shumë vjersha dhe shumë e shumë rrëfenja të vërteta mbi bëmat e tyre. Këndohet me meritë për kapëdanët trima të shquar, luftëtarë të pa epur, shpëtimtarë të vendit tonë. E kanë shkruar historinë me veprimtarinë e tyre, me rrjedhën e jetës, prandaj dhe arti popullor nuk citon shumë detaje mbi trimërinë e tyre. Ata njihen si heronj sypatrembur që iu kundërvunë një perandorie të madhe e cila në atë kohë



(pushtimi i Perandorisë Osmane) shtrihej në tre kontinente. Labë (toskë) të lindur për të mos vdekur kurrë. Emra që i përkasin përjetësisë. Këto këngë e vjersha të thurura me pathos të lartë për ta, janë meritë e fituar nga njerëz që gjithë jetën ja dedikuan dashurisë për vendin. Kanë qenë bashkëluftëtarët, bashkëqytetarët, bashkëmoshatarët e tyre që kanë krijuar këngën. Këngë që buron nga përjetimi për të cilin poeti popull tregon dhe ruan brenda ndërgjegjes se vet bëmat dhe veprimtarinë e kapedanëve të tij, të cilët gjithashtu janë burim i gjirit të tij.

Në këto vargje shumë domethënëse thuhet:
“Njëri Rjekë tjetri Cetinjë,
Për të mbrojtur kufinë”

Në të njëjtën periudhë kur fqinjët lakmitarë të jugut rrëmbenin pjesë Shqipërie, ndihma për vëllezërit e tyre gegë nuk ka munguar kurrë. Asokohe, territoreve arbërore ju ishin sulur të gjitha shtetet shoviniste fqinje që e rrethonin, për të rrëmbyer sa më shumë pjesë. Kur bëhet fjalë për të mbrojtur atë mëdheun, vëllazërimi i shqiptarëve bëhej pa dallim krahine dhe

besimi fetar, pa dallim shtrese shoqërore apo politike, pa dasi përçarëse. Ishim një, një e vetme, si heronjtë mitik, bashkë për të ruajtur token, atëmëmdeheun, të pacenuar. Kapedanët e jugut luftonin krahë për krahë me kapedanët gegë. Kufijtë e Arbërisë nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim, janë mbrojtur pa as më të voglin hezitim, me sakrificë e me humbje të mëdha. Duheshin mbrojtur që të vazhdonte jeta, të bëhej vazhdimësia të cilën armiqitë e saj nuk kishin mundur dot ta zhbënin në shekuj e shekuj me radhë.

Poeti vazhdon e i drejtohet Labërisë, vatrës së tij, dhe i thotë:
“Çke që qan moj Këndrevicë,
E larta mbi male gjithë?”
Thërret malin më të lartë të Labërisë, krahasuar me majat e larta përreth, siç është Olimpi. E pyet me pyetje retorike, duke të lënë të kup-tosh që po i drejtohet qiejve, e akoma më lartë, Zotit vetë. I drejtohet malit më të pamposhtur të vendlindjes së tij. Këndrevica lartësohet me retë, e papërkulshme, e lirë dhe krenare. Poeti i drejtohet të mos heshtë për bijtë e saj, pa dallim, prijësa dhe luftëtarë, bij të gjallë të cilët i dalin vendit për zot.
Vazhdon tregimin e tij duke ju përgjigjur pyetjes po vetë, si më poshtë vijon:
“Qaj për trimn’ e Shqipërisë,
I shkreti Hodo Nivicë,
Bën dyfek në Podgoricë,
Bam ja bëjnë e dot se vrisnë.”

Labëria qan për trimin e Shqipërisë, pra biri saj tashmë nuk ishte vetëm i Labërisë. Trim i cili vlerat, virtytet veprimtarinë patriotike - atdhetare e vuri si qëllimin e jetës së tij, mbrojtjen e saj në planin e parë, për Shqipërinë e trashëguar nga të parët e tij. Trimi që luftoi heroikisht pa bërë asnjë hap mbrapa, ku edhe pse armët armike shkreheshin me breshëri drejtim tij - “dot se vrisnë”. Batore pushkësh shkreheshin e prapë nuk ja morën dot jetën. Më bukur nuk mund të thuhet. Kënga labe është e lashtë sa vetë Labëria. Ajo është dëshmi e gjallë e një kulture që i ka kënduar si i vetmi instrument muzikor të gjitha halleve gëzimeve dhe trimërisë të trevës, po edhe me gjerë. Janë ndikimet shoqërore, natyrore, historike që e kanë zhvilluar në shekuj këtë dukuri, duke e fiksuar si një kulturë me tipare të ngritje-uljes e forcës së zërit.
Kjo vepër do të mbetet thesar i trashëgimisë sonë kulturore e shpirtërore. Art që dhuron kënaqësi edhe sot, mbas 170 vjetëve, të cilën e arrin vetëm populli, Poeti “Unë”!



SA MË SHUMË KALON KOHA, AQ MË SHUMË SHTOHET DASHURIA PER VËNDËLINDJEN

Nga Xhelo Tozaj

Një ditë vizitova bashkëfshatarin tonë dhe mik në fisin tonë, të nderuarin Abaz Dautin dhe duke biseduar e pyeta për të kaluarën pasi në kohën e lindjes time (ndonëse nuk jam i ri) ai ishte adoleshent. E ngacmova që t’i hapja oreksin për të treguar të kaluarën e tij në ato vite. Mësova se kushtet ekonomike dhe hallat e kohës nuk frenonte gatishmërinë e të rinjve për gjendjen e kohës në ndërtimin e vendit. Abazi si gjithnjë modest nuk e nisi me veten, por më foli për aftësitë organizuese të bashkëfshatarit Dasho Memushi që printe në krye të rinisë në aksione. Tre herë kishin shkuar në aksione në ndërtimin e hekurudhave dhe kujtoi që në Elbasan e kishin ngarkuar me detyrën e korrierit për korrespondencën dhe shtypin e kohës.
Duke treguar për hekurudhat kujtova që rinia e Kallarait gjithmonë aktive në vitin 1968 kur unë isha caktuar në një detyrë rinore në hekurudhën Rrogozhinë - Fier në sektorin e Mbrostarit, pata fatin në muajt Maj- Qershor të punonim së bashku me të rinjtë kallarratas që në krye të tyre qëndronte fisniku fjalë pak Njazi Xhaferaj. Do kujtojë disa nga emrat si Rabua, Refati, Jemini etj (më falni që nuk i kujtoj të gjithë, por kujtoj vlerësimin sulmues). Kthehemi tek Abazi nga viti 1955 shkon në shkollën e bashkuar të oficerëve për nevojat e kohës ku doli me rezultate të larta dhe ju besua shërbimi në një armë të re të futur rishtas në ushtri dhe shërbeu për vite e dekada në sektorin politik në Karaburun, Vlorë, Kuçovë, Lushnjë e Durrës ku ka mbajtur shumë urdhra e medalje. Gjithnjë Abazi ka qenë i lidhur me fshatin edhe se i moshuar një familje tradicionale labe që e ka transmetuar jo vetëm tek fëmijët, por edhe tek nipërit inxhinier. Nuk harrohet kontributi

i tyre që në takimin e brezave u ndriçuar nga investimi i tyre dhe shikojmë në internet Abazin që i ndihmuar fizikisht jep intervistë dhe i urojmë jetë të gjatë se për shoqatën na mban gjallë Gjergji.
Si përfundim komplimente shoqatës Kallarati (kryesisë të saj) që na mban në korrent për çdo gjë. Me këtë shkrim përulem para kallarratasve kudo që janë dhe para atyre që kanë ngritur lart emrin e Kallarait në luftë edhe në punë. Respekte.



Dori, që me mirësinë dhe buzëqeshjen, sfidoi jetën

Faqe ekspluzive për gazetën “Kallarati” për ndarjen nga jeta të Dorjan Luto Demirit

nga Besnik Gjonbrataj dhe Valgerta Demiri

“Nuk ka invalidë në shpirt, ka vetëm zemra që rrahin më fort për jetën.”

Helen Keller

“Ka njerëz që ndriçojnë jetën tonë, edhe kur fati i rëndon mbi supe. Dori ishte një prej tyre. Ai nuk e pranoi kurrë humbjen, nuk e la dhimbjen ta mposhte. Në vend të saj, zgjodhi buzëqeshjen, dashurinë dhe forcën e shpirtit, duke na dhuruar të gjithëve një shembull të pashlyeshëm.”

21 shkurt 2025. Sot, Kallarati përcolli me nderime të veçanta Dorin, një njeri me zemër të madhe, të dashur, buzagaz dhe inteligjent. Pjesëmarrja e madhe dhe kurorat e shumta me lule mbi varrin e tij dëshmuar respektin dhe vlerësimin e bashkëfshatarëve, miqve dhe shokëve të familjes, Dorit dhe jo vetëm. Kjo përcjellje dinjitoze ishte shprehje respekti dhe mirënjohje ndaj Dorit, i cili do të mbetet gjithmonë në kujtesën e të gjithëve.

FJALA E LAMTUMIRËS PËR NDARJEN

NGA JETA TË DORJAN LUTO DEMIRIT

Të dashur prindër të Dorit, Luto e Vera Demiri!

Të dashura motrat e Dorit, Loreta, Etleva, Eglantina, Valgerta dhe vëllai Detion!

Të dashur familjarë, nipër, mbesa e të afërm të Dorit!

Të dashur bashkëfshatarë kallaratas, miq e shokë të familjes Demiri dhe të Dorit!

Jemi mbledhur sot, me zemrat mbushur me lot e dhimbje, për t'i dhënë lamtumirën e fundit Dorit tonë të dashur, buzagaz, të mençur, Dorit inteligjent, që pas një sëmundjeje të gjatë e të rëndë, u largua nga kjo botë, të cilën e përballoi me kurajo e dinjitet, me shpresë dhe forcë.

Nuk e kisha menduar kurrë që do të më duhej të shkruaja fjalë lamtumire për Dorin në këtë moshë të re, aq më tepër për komshiun tim të dashur. Dhimbja është e madhe dhe mungesa e tij do të ndihet përherë. Por ajo që na mbetet të gjithëve janë kujtimet e bukura, buzëqeshja e tij e ngrohtë dhe fjalët e mençura e plot dashuri.

Dori u largua nga kjo botë pas një beteje të ashpër me sëmundjen, një beteje që e përballoi me forcë dhe dinjitet, duke u bërë shembull frymëzimi për të gjithë ne. Ai ishte njeriu që nuk u dorëzua kurrë, që përballoi dhimbjen me buzëqeshje dhe sfidat me vendosmëri.

Ndarja e tij do të lerë një boshllëk të pamasë, jo vetëm për prindërit e tij të dashur, Luton dhe Verën, për motrat e vëllain, që e deshën dhe i qëndruan gjithmonë pranë, por edhe për të gjithë



ne, bashkëfshatarët, miqtë dhe shokët e tij.

Dori nuk ishte thjesht një djalë i fshatit tonë, ai ishte një urë lidhëse mes bashkëfshatarëve. Ai ishte pjesë e pandashme e shoqatës “Kallarati” që me pasionin e tij për vendlindjen, na mbante gjithmonë të lidhur me rrënjët tona. Fotot nga Kallarati, mesazhet dhe dashuria e tij për vendlindjen i jepnin frymë e shpirt gjithsecilit prej nesh.

Ai ishte shumë inteligjent, ai jetonte me realitetin, në fytyrën e tij kishte vetëm buzëqeshje dhe urtësi. Edhe pse një kohë të gjatë në karrocë, ai shëtit kudo, pa, përjetoj jetën, njëlloj si gjithë moshatarët e tij, ai nuk u ankua asnjëherë, por me kurajo e vendosmëri përballoi jetën, ashtu siç i erdhi.

Kjo ndarje e Dorit është e rëndë për ju prindërit, që sakrifikuat për vite me radhë, që bëtë gjithçka për ta mbajtur Dorin pranë, që i shërbyet deri në fund të jetës!

E dhimbshme është për ju motrat e vëllain, për ju nipër e mbesa që e deshët dhe bëtë aq shumë, për të dhe që do ta mbani gjithmonë të gjallë në zemrat tuaja.

Kjo ndarje është e rëndë edhe për të gjithë shokët e tij, që e deshën, e respektuan dhe nuk u ndanë asnjëherë prej tij.

E rëndë për të gjithë ne bashkëfshatarët që ndahet nga jeta një djalë në këtë moshë si Dori, një djalë që do ta kishim pjesë të çdo feste gëzimi në Kallarati. Dori si çdo fëmijë kishte ëndrra, kishte shpresa, kishte dashuri për dije e për jetën, por sëmundja e padrejtë ia shkurtoi shumë shpejt rrugën. E megjithatë, ai jetoi me pasion, me dinjitet dhe me forcën e atyre që e dinë, që jeta duhet jetuar ashtu siç të vjen deri në frymën e fundit.

Dori sot, largohet fizikisht, por ai do të mbetet gjithmonë i pranishëm në kujtimet dhe zemrat tona. Drita e shpirtit të tij nuk do të shuhet kurrë, sepse ai ishte një njeri i veçantë, një shpirt i pastër, që la gjurmë të pashlyeshme tek të gjithë njerëzit.

Lamtumirë, Dori ynë i dashur! Lamtumirë, o engjëll i buzëqeshur!

Shpirti yt u prehtë në paqe dhe kujtimi yt qoftë i bekuar!

Prehu i qetë në vendlindjen tënde të dashur!

Qoftë i paharruar kujtimi i tij! Lamtumirë Dori!

KOMENTE E VLERËSIME PËR DORIN NË FAQEN E FEJSBUKUT

“Lamtumirë vëllai ynë i shtrenjtë! Shpresojmë të kesh gjetur shërimin tënd, o Yll i bukur i Parajsës”!

– Nga Detjoni, Loreta, Etleva, Eglantina e Valgerta –

Loreta Ferraj (Demiri motra): Sot mbushe një muaj që ti u largove dhe nuk na besohet Akoma. Me ikjen tende jeta jonë nuk është e njëjtë dhe asnjëherë nuk do jetë.... Me ikjen tende ne na ikën gjërat që ne ishim mësuar (fotot, komentet, mesazhet, shakatë që ti na dërgoje shpesh te grupi jonë). Na mungon buzëqeshja jote....Ti Dori ju mungon shumë të gjithëve, babit, mamit, vëllait, motrave dhe të gjithë nipërve dhe mbesave. Ti u falje dashuri të gjithëve, por sado që ti nuk je mes nesh fizikisht Ti PËRHERË do ngelesh në zemrat tona. NA MUNGON TMERRËSISHT, Të duam pa fund. Rest in peace my brother!.

Etleva Leskaj (Demiri) motra:

Sa shumë po më mungon,
sa shumë po më lëndon.
Malli shumë shtohet,
... dhimbja nuk durohet.
I ri ike nga kjo botë,
Duke na lënë vetëm lot!!!

Eglantina Shytaj (Demiri) motra:

Kam nisur dhjetëra herë të shkruaj dy fjalë, por s’ kam patur forcë në zemër e as fuqi në duar..
Sa më shumë kalojnë ditët nga ikja jote Doro, dhimbja rritet..., por dashuria dhe mbështetja e pafund njerëzve që të kanë dashur ty është një mbështetje e madhe për ne.

Jeta u tregua e padrejtë më ty, por ti e sfidove atë sepse ti ia dije vlerat jetës e vërtetë. Luftove gjithë jetën për të treguar se vlerat mbizotërojnë edhe atëherë kur duket e pamundur.

Ti Doro na dhe një model ndryshe, na mësove se në këtë botë të vështirë ia vlen të jetosh me vlera, me mirësi, me besim, me dinjitet dhe me dashuri për njerëzit.

Faleminderit që na ke falur kaq shumë dashuri dhe mirësi, vëllai im!

Violeta Xhaferaj, mësuesja e Dorit: O Dor, Doriiii, Nuk mund të rri pa shkruar dy rreshta mësuesja jote, o Dor! Ma copëtove dhe ti zemrën, o djali flori! Ti, Dori, ishe djali i lagjes, ishe rritur bashkë me shokët, bashkë ishit vlarë e copëtuar këmbët e gjunjët nga lojërat e ndryshme që bënit. Erdhe në klasë të parë një fëmijë i urtë, i ndrojtur, fjalëpakë e syzguar. Mirë ece deri në klasë të katërt, pastaj mezi i ngjisje shkallët, derisa arrite që të ngrinin shokët, diçka nuk shkonte, por nuk besuam deri ku arrite. Nuk luajte më me shokët, por bëje tifozllëk, e vuaje shumë këtë. Jeta jote prej 30 vjetësh edhe në roman nuk përmbledhet, sepse gjatë gjithë këtyre viteve ti ke qarë, je nevrikosur,

je dëshpëruar e ke thënë “pse unë “!”, por asnjë nuk e deshi këtë mavri sëmundje. Çfarë nuk bënë prindërit e Tu për të të kuruar e shëruar, por Jo, nuk arritën dot, të shërbyen me gjithë përkushtimin e tyre si familje dhe ti ua shpërbleje me buzëqeshje atyre dhe të gjithëve kush të njohu. Nuk do pimë më kafe bashkë, të më pyesësh gjerë e gjatë për të gjithë, oh sa do më mungosh, o Dor! Ty, Zoti të mori shumë, por të dha edhe shumë, kulturën, inteligjencën, mirësjelljen, respektin për këdo. Kështu do të mbetesh në kujtesën time derisa të jetoj e kështu do të mbetesh tek të gjithë kush të ka njohur, o Dor. E kam të vështirë të të them LAMTUMIRË, poooooor ndodhi.

Pëllumb Gjonbrataj: Dora dridhet, sytë lotojnë, zemra qan në këtë mesazh ngushëllimi për ndarjen e parakohshme nga jeta të Dorit tonë të dashur, Dorit inteligjent, Dorit buzagaz me të gjithë, shoku i mirë i djemve të mi, një nga djemtë e shkëlqyer të fshatit. Jeta nuk të përkëdheli, por në saj të kujdesit të veçantë prindëror, vëllait e motrave, ti kurrë nuk u ligështove, ti ishe kurajoz për jetën, ti rrezatoje dashuri e mirësi për të gjithë! Dori na ke helmuar pa masë, nuk do të mundim të takojmë më tek klubi i fshatit, apo te kafja e te lulishtja në Vlorë. Ti Dori do të mbetesh i paharruar për prindërit, vëllain Detjonin, motrat e gjithë të afërmit e shokët e shumë që të rrethonin! Qofsh i parajsës o Dori ynë i dashur!

Lavdosha Jonuzaj: Zoti e kishte bërë engjëll, në pamje, në fjalë, në sjellje, por fatkeqësisht i kishte dhënë edhe sëmundjen e pa mëshirshme që i mori jetën para kohe. U prehtë në paqe engjëlli i Lutos dhe i Verës. Prindërit, vëllai, motrat, farefisi, shoqëria dhe gjithë bashkëfshatarët kallaras e të gjithë ata që e njohën Dorin do ta kujtojnë gjithmonë me atë fytyrën e ëmbël engjëjllore dhe ti do t’u falësh si ngaherë buzëqeshje. Ahhh more Dori, sa herët ike, shoku dhe vëllai ynë i fëmijërisë, nuk gjejmë fjalë për ty, por zoti të do pranë vetes e prandaj të mori kaq herët, shpirti yt pushoftë në parajsë. Ngushëllime prindërve motrave dhe vëllait, i përjetshëm emri dhe kujtimi i Dorit. Një buzëqeshje nga lartë në qiell, atje ku do prehesh përgjithmonë. Të qoftë dhe i lehtë o engjëll. Ngushëllime të sinqerta familjes.

Rajmonda Breshanaj: Përjetë në zemrat tona Dori. Jeta e tij ishte e një heroji të vërtetë. Fali pafund shumë dashuri, buzëqeshje, i jashtëzakonshëm në komunikim me gjithë njerëzit e çdo brezi,

i gjithanshëm për informacionet në çdo fushë të jetës. Kishe shumë kënaqësi kur e takoje, kudo që shkonte kishte përreth dashurinë e familjarëve, të shokëve të tij. Përkushtimi në maksimum i prindërve të tij të dashur, i vëllait, i motrave, nipërve dhe mbesave i shtuan buzëqeshjen. Atë dashuri që fali është kthyer në një dhimbje të madhe, e kjo dhimbje të kthehet në forcë për gjithë familjen. Qoftë një engjëll mbrojtës për juve të gjithë.

Lefter Hysaj: Ngushëllime të përzemërta prindërve, vëllait, motrave. Dori iku me buzëqeshjen e tij të pavenitur ,iku në qiell si engjëll, iku si një trim, ku sëmundja për asnjë çast nuk mposhti për më shumë se 30 vjet, iku për të buzëqeshur me dritën e yllit si për të na thënë: “Unë jam këtu, u shikoj nga lart, jetojeni jetën vetëm me mirësi e buzëqeshje”. Të qoftë dhe i lehtë Dorjan!

Ertenida Hysaj: E dhimbshme, shumë e dhimbshme! Kishe bërë vend në zemrën e të gjithëve Dori dhe ashtu si pa dashur, se ti ndaje vetëm mirësi, na helmova të gjithëve vëlla. Zoti ju dhentë forcë të gjithëve! Xha Luto dhe halla Vera jemi pranë jush në këto orë të vështira dhe ndajmë me ju këtë dhimbje të madhe. Qofsh i parajsës Dori dhe të gjesh shërim aty në gjirin e zotit! Lamtumirë vëllai ynë!

Liri Shkurti: Lajm i pabesueshëm dhe shumë i dhimbshëm. Nuk më besohet për Dorin. U largua nga jeta para kohe. Dori ishte djalë inteligjent, i dashur, i qetë dhe i respektuar. Këmbeshim në rrugë dhe larg, të ishte përshëndeste me buzën në gaz, që ishte karakteristika e tij. Ngushëllime të sinqerta, Lutos, Verës, Detionit, Loretës, Etlavës, Eglantinës dhe Gertës, për Dorin. U dhëntë Zoti forcë për të përballuar këtë dhimbje të madhe!

*I pa harruar përjetësisht KUJTIMI I TIJ!
U prehsh i qetë në parajsë, DORI!*

Kastriot Qejvani: Dori na plagose na lëndove, na hidhërove shumë. Të donim shumë si nga sjellja jote por edhe nga e keqja që të zuri dhe nuk t’u nda deri sa të mori jetën, por ti do të shkosh në parajsë se atje e meriton. Lamtumirë Dori i dashur! U prehsh në paqe vëllai ynë i shtrenjtë!

Besnik Gjonbrataj: “Një kujtim i paharruar me Dorin, njeriun që pjesën më të madhe të jetës e kaloi në karrocë, por kurrë i mposhtur. Me forcën e shpirtit dhe buzëqeshjen e tij, ai sfidoi çdo pengesë, duke na dhënë të gjithëve një mësim të madh “Jetoje jetën ashtu si të të vijë!”

Luto e Vera Demiri (Prindërit e Dorit): Mirënjohje dhe falënderim për të gjithë të afërm, miq, bashkëfshatarë edhe shokë të Dorit që na qëndruat pranë në këto dite të vështira! Paçi vetëm ditë të lumtura në familjet Tuaja!



NGA MOTRA E TIJ, VALGERTA DEMIRI

Edhe sonte u ktheva në morinë e kujtimeve tona; sapo mbështes kokën në jastëk, mendimet shkojnë vetëm te ti – jo se ditën të harroj, por nata nuk mi tregon lotët që kam në sy...

E di çfarë?! Për çudi kam vetëm sekuenca të vogla festash dhe njerëzish, por kujtimet e mia nisin me ty.

Unë jam në klasë të parë, ti në të pestën – mua-jin as ditën nuk e di – unë një imcake e vogël, ti një bukurosh me flokët kaçurrela, bardhosh, shtat të lartë, e këmbët e holla që fillonin të çalonin pak. Mami më çonte mbi supe dy çantat tona: “Hajde, merri të dyja ti se lodhet djali”; “Kalo poshtë nga shtegu, jo nga shkallët, se mezi ngjitet djali”; “Kujdes djalin...”

E di, kam qenë një inatçore: unë kaq e vogël, pse duhet të mbaja dy çanta?! Kaq e vogël, pse duhet unë të kisha kujdes për ty?! Ti buzëqeshje, dhe sapo kalonim kthesën e shtëpisë më thoshe: “Hajde, të të ndihmoj dhe unë.” Iknim ashtu – herë shpejt, herë me hap të ngadaltë; herë luanim rrugës, herë ziheshim. Unë me inat mbi krye, e ti buzagaz... Për tre vjet i njëjti itinerar. Ty te shkallët e shkollës të prisnin shokë e shoqe, mer-rnin çantën dhe të ndihmonin të shkoje në klasë; kurse shokët e mi... ah, hileqarë, s’dolën të më prisnin për në klasë.

E mban mend kur ikje për kohë të gjatë nga shtëpia? Më tregoje që ishe në Vlorë, Fier, Tiranë. Ti më flisje vetëm për gjërat e bukura, pa treguar vështirësitë apo ditët që endeshe në spital, ndërsa unë mërzhitesha se vendet e bukura kurrë s’i kisha parë.

Po “play station”-in e mban mend? Sa shumë luanim Super Mario, e nuk fitova asnjëherë... Më thuaj: vërtet i mësoje të gjitha truket e lojës, apo ma bëje me hile?

Video game, bilardo, lego, letra, TV i fundit, Digitalb... çdo gjë që dilte, ti e kishe i pari dhe ftoje gjithë shokët e lagjes të luanit bashkë. Sa shumë luaje letra me shokët e lagjes e më larg – ziheshit, bërtisnit për lojë, hidhnit baste, por ishit



shokë prapë.

Po kampionatin botëror? (Nuk mbaj mend vitin.) Ti ishe tifoz me Brazilin, dhe ne bënim tifo për ty. Sa herë ti bërtisje “gol”, “gol” bërtiste edhe mami, sepse të shikonte gëzim në sy.

Mbaj mend një ditë me diell, kur babi solli një karrocë që ti të lëvizje dhe të mos lodheshe shumë (të paktën unë mendoja se ashtu i kishin thënë doktorët: “të mos lodheshe shumë”). Sa shumë gëzuam! Hipëm, bëmë xhiro anë e mbanë – herë në rrugicën pranë shtëpisë e herë në rrugën e shtruar me gurë. Dhe ta mendosh... atë e kam quajtur “makinën tonë të parë”! Unë gëzoja, sepse tani mund të vraponim të dy bashkë.

Doro – “TI QË NUK U ANKOVE KURRË, POR NA MËSOVE GJITHÇKA”

Ky shkrim që botojmë në numrin e radhës të gazetës “Kallاراتi”, është një rrëfim personal dhe tejet i ndjerë i Valgerta Demirit, i shkruar me dashuri, mall dhe mirënjohje të pafundme për vëllain e saj, Dorjan Demirin, ndarë nga jeta ose Doron, siç e thërriste ajo me përkëdheli. E botojmë me bindjen se kujtimi i Doros nuk është vetëm i familjes, por i të gjithë atyre që e njohën dhe e deshën atë.

Redaksia



Ah, i pafajshmi fëmijë! Ti më mësoje të ndërroja gomat, kamerdaret, kopertonin; ngjisnim plagët e karrocës me “atak”, sepse ajo tashmë do të ishte shoqëruesja jonë.

Ditëlindjen tënde të 15-të e festove në atë karrocë – tashmë një buçko e shumë kushërinj që të rrinin pranë. Festuam, gëzuam, dhe kujtimet tona i memorizua në një aparat.

Vitet kalonin, unë ika në shkollë, e sa herë vija, ti më prisje buzagaz. Dimrit ngroheshim në oxhak, luanim letra, plotësonim sudoku dhe fjalëkryqe. Ti i fshihje gazetatat për t’i plotësuar vetë, por unë i gjeja prapë. Bënim garë kush gjente më shumë këngë të viteve ’80-

’90, dhe ti me Tinën bëheshit bashkë, më bënit hile deri sa unë qaja – e pastaj më merrje me të mira: “Hajde, se bëmë shaka.”

Po karamelat “Boero”? Ne i ndanim nga pesë secili, dhe unë vrapoja t’i haja shumë shpejt, e ti ngadalë prisje sa unë mbaroja, e pastaj më bëje zili.

Ah, Doro, ke qenë shpesh herë hileqar me mua, ti! Më ngacmoje se e dije që unë isha inatçore, ndërsa ti vetëm qeshje.

Ty të donin dhe të flisnin të gjithë në fshat: “Dori, më shiko pak telefonin se nuk punon”; “Dori, më shiko pak televizorin, se çfarë ka.” Ti kurrë nuk përtoje, dhe me aq sa kishe mundësi,

i ndihmoje.

Vitet iknin. Ne të gjithë ishim larguar, derisa në 2011 vendosët të vinit në Vlorë – të tre bashkë: ti, mami, babi. Tashmë u kthyem të jetonim bashkë. Në fillim i ndrojtur dilje me ne në kafe me rrallë, pastaj na merrje në telefon dhe na bëje të gjithëve bashkë. Verës, pothuajse për gati pesë vjet, jetuam më shumë bashkë – teksa mami dhe babi donin të iknin në fshat, ndërsa ne, me motra e vëllain, iknim në plazh.

Sa qejf e kishe detin, Doro! Rrije brenda në ujë me orë të tëra. “Ja, shiko – po lëviz, po noto!”



I mban mend netët tona deri vonë zgjuar?! Tashmë ishim në teknologjinë e internetit – gjithë natën luanim, lexonim, lundronim në internet, dhe gjumi na zinte aty nga mëngjesi. Ose më saktë: shtriheshim që babi dhe mami të mos na gjenin zgjuar. Atë periudhë, secili në mënyrë të fshehtë lexonim edhe për sëmundjen tënde në internet. Askush s’i tha tjetrit çfarë lexuam, por me sy, dita-ditës, u kuptuam.

Atë që babi e mbante mbi supe prej vitesh, e kuptova shumë vonë. Ndoshta, në fëmijëri besoja në mrekulli – në tregimet me zana e me super-fuqi – por vitet më mësuam që karroca do të ishte bashkudhëtare në jetën tonë.

Ti dilje çdo ditë dhe bëre shumë miq. Flisje me të gjithë me mirësi. Dilje me shoqëri në dreka dhe darka. Të gjithë të respektuan e të deshën – për zemrën e pastër dhe humorin e hollë, për fjalën e dashur e njeriun e rrallë që ishe.

Shpeshherë edhe ne të ngacmonim që doje më shumë shokët, pasi ti kaloje më shumë kohë me ata. E shpesh, shoqërinë tonë e bëre më shumë ti, sesa ne.

Bëre shumë miq të rinj, por nuk harrove kurrë shoqërinë e vjetër. I bëje bashkë sa herë kishe mundësi. I ftoje miqtë e rinj të pinin kafe në klubin e vjetër. I krijove lidhjet me qytetin, por nuk harrove kurrë miqtë e fshatit. U shtrive me ta në buzën e detit, por i bëre bashkë dhe në sofrën e dashur të Kallaratit.

Ti ishe nipi i preferuar i hallave, dajove, tezeve dhe xhaxhit, sepse më shpesh se ne të tjerët, ti i merrje në telefon.

Ti bëje lidhjen me të gjithë kushërinjtë, teksa të gjithë ne nxitonim në punët tona. Ata kishin ty të parin, dhe të gjithë flisnin me ty, Doro. Disa, larg në mërgim, shkëmbenin telefonata; e kushërinjtë këtu afër të shëtitnin ngado.

Ti ishe pika e lidhjes me të gjithë. Me të gjithë shkëmbeje mesazhe, batuta, telefonata. Secili prej tyre për ty kishte veçanti, dhe ti me të gjithë le kujtime të bukura mbrapa.

Por ti ishe dhe dajo i dashur. I doje nipërit e mbesat, secilin në mënyrë të veçantë. Ishe merakli kur ata ishin të vegjël dhe vriteshin, por u bëje krenar teksa ata rriteshin. Ama, lumturinë më të madhe e pamë kur u bëre xhaxha. E the me plot krenari: “Tani jam xhaxhi i Drilonit.” Dhe ai u rrit me dashurinë e madhe për ty.

Sa shumë nipër e mbesa rreth teje: Eneriko, Enxhi, Ervisi, Klajdi, Valeria, Vanesa, Alesia,



Drini, Aria dhe Hana – të gjithë të donin dhe të rrinin në krahë, përqaftuar. Ata kurrë nuk pyetën, por vetëm kuptuan që ishte një dajo/xhaxha shumë i veçantë.

Kur ishin të vegjël, u bëje xhiro me karrocë; e tani që ata po rriteshin, ti i kishe krahë.

Me Kasemin, Çimin, Ilirin, Florin, Nelen – me secilin kishe komunikimin tënd të veçantë. I thërrisje të gjithë me emër, e ndonjëherë me shaka “kunat/e”. I deshe njësoj siç na doje ne, dhe ata të deshën ty, Doro, si një vëlla.

Sivjet, si për çudi, më kujtonte pak fëmijërinë. Dikur gjatë javës shkonim bashkë në shkollë; sivjet, gjatë javës para-dite, rrinim në kafe bashkë.

Dikur fëmijë e moskokëçarës, tani të rritur, bënim muhabet.

Fundjavat na mblidhje të gjithëve bashkë. Merrje babin, mamin, vëllain, motrat – por nuk harroje as Lorin në video call, sepse e kishim larg.

Ku do ta pimë kafen? Në Lun-gomare apo te lokali i Detit?

Doje të ishte gjithandej – në kafe, në det, në mal... Nuk u lodhe kurrë nëpër udhëtime; doje veç të dilje dhe të krijote sa më shumë kujtime.

Ah mor Doro, sa shumë kuj-time... Fjalë vetëm të bukura le.

Si nuk u ankove? A ndjeve dhimbje ndonjëherë? A të lënduam, rënduam? Kurrë nuk na the!

Si nuk u ankove për pamundësinë, por u për-poqe që, ashtu siç Zoti ta fali jetën, ti ta shijote në çdo grimcë.

Ti ishte fjala jonë e ëmbël, që kishe veç buzëqeshje e mirësi. E ke idenë sa dhimbje le mbrapa, e sa lot që kurrë nuk thahen në sy?

Na mungon aroma jote, Doro... Ky ajër që thithim ditë për ditë po na mbyt.

Mami, babi po treten ngadalë – të kërkojnë ty, Doro... ty, dritën e shtëpisë.

Përpiqemi të shikojmë njëri-tjetrin me forcë... por, ah, Doro – forca jonë paske qenë veç Ti.



Dori ishte një dritë që nuk u shua as nga dhimbja, as nga sëmundja. Ai e sfidoi fatin me mendjen e tij të ndritur, me fjalën e ëmbël dhe me dashurinë që falte pa kushte. Në çdo takim, në çdo bisedë, në çdo çast të jetës së tij, ai na mësoi se vlera e një njeriu nuk matet me gjymtyrët që e mbajnë, por me zemrën që e udhëheq. Loti për të nuk është vetëm dhimbje, por edhe mirënjohje. Ai iku nga kjo botë, por kujtimi i tij do të jetojë gjatë tek të gjithë ata që patën fatin ta njihnin.



*Lamtumirë,
Dori ynë i dashur!
Kujtimi yt do të
mbetet i paharruar
në zemrat tona!*

DEDIKIM PËR DORIN, SHOKUN TIM TË PAHARRUAR

- NGA ELIDIAN GJOMBRATI

Dori, më dridhet dora dhe më rëndohet zemra teksa shkruaj këto fjalë. Nuk doja kurrë të besoja se do të vinte dita të t'i drejtoja fjalët kështu, me dhimbjen e pashuar të mungesës tënde. Të kërkoja nëpër kujtime, nëpër rrugët ku ecëm bashkë, në bisedat që nuk do t'i harroj kurrë... por më duhet ta pranoj se na ike para kohe, duke lënë pas një boshllëk që asgjë nuk e mbush.

Sa më dhemb që nuk isha pranë teje në ato momente të fundit, që nuk munda të të përcilla me një grusht dhe në banesën e përjetshme. Emigrimi më mbajti larg, por shpirti im ishte aty, bashkë me të gjithë ata që të deshën dhe të respektuan. Edhe tani, nuk dua ta besoj se nuk do të dëgjoj më zërin tënd, nuk do të shoh më buzëqeshjen tënde të ëmbël, atë forcë e dashuri që e shpërndaje kudo.

Ti ishe shok i rrallë, i palodhur, i men-çur e i guximshëm. Nuk e le kurrë veten të mposhteshe nga sëmundja. Gjithmonë me ne, në çdo bisedë, në çdo moment të bukur që ndanim. I kujtoj udhëtimet tona në Qeparo, Gusmar, Nivice, Progonat, Himarë, Gjirokastrë, Sarandë, bisedat e tua të mençura, humorin tënd, kujdesin që kishe për të gjithë.

Ti ishe shumë i dashur dhe intereso-heshe në çdo moment, sidomos për lagjen tonë, më thojë çdo mëngjes për të lagjes, për teta Shazen, për Gentin, teta Afërditën, xhaxh Për-parimin, për prindërit e mi. Më thojë, për njerëzit tanë, për ata që i takojë rrugës dhe nuk harroje kurrë të më qetësoje me fjalët e tua të ngrohta: “Mos ki merak, janë mirë!”

Dhe më kujtohet ai çasti, kur erdhe në parburgim për të takuar shokun tënd të pandarë, Eraldin. Nuk munda të mbaja lotët kur të pashë, ashtu të fortë, të ndershëm, me shpirtin e pastër, duke sfiduar çdo vështirësi vetëm për të qenë pranë atyre që doje. Ata lotët e tu nuk do t'i harroj kurrë, as fjalët, as mënyrën se si arrije të prekje zemrat e të gjithëve.

Dori, vëlla, shok i paharruar, ti nuk ike, ti do të jetosh gjithmonë mes nesh, në kujtimet që kemi ndarë, në rrugët ku kemi ecur bashkë, në çdo fjalë të ngrohtë që na ke thënë. Do të jesh gjithmonë pjesë e jetës sonë, ashtu siç ishte: një dritë, një frymëzim, një zemër e madhe që rrahu fort për miqtë, për familjen, për vendlindjen.

*Pusho në paqe, Dori, shoku im i dashur i fëmijërisë dhe i lagjes!
Do më mungosh gjithmonë fizikisht, por jo në kujtimet tona!*

DORI, QË ME MIRËSINË DHE BUZËQESHJEN, SFIDOI JETËN

BOTUAR NË GAZETËN DESTINACION
Nga Besnik Gjonbrataj

Dorjan Demiri, apo siç e thërrisnin të gjithë me dashuri, Dori, i ndarë para kohe nga jeta ishte një shembull i rrallë i forcës dhe qëndresës njerëzore. I lindur në Kallarat më 11 nëntor 1983, në një familje të dashur dhe të përkushtuar, nga prindërit Luto dhe Vera Demirit, Dori kaloi një jetë sa të vështirë, për shkak të një sëmundjeje të rëndë, aq edhe të bukur, në sajë të kujdesit prindëror të motrave vëllait, por edhe shoqërisë së tij të shumtë.

Që në fëmijërinë e tij, ai u dallua për dashurinë ndaj familjes, buzëqeshjen e tij të përhershme dhe shpirtin e tij të madh.

Jeta nuk e trajtoi me butësi. Një sëmundje e rëndë, e shfaqur në vitet e para të shkollës tetëvjeçare, e detyroi të përballej me sfida të jashtëzakonshme. Megjithatë, ai nuk u dorëzua kurrë. Edhe pse i detyruar të kalonte pjesën më të madhe të jetës në karrocë, ai nuk e lejoi asnjëherë që kjo të zbehte dëshirën e tij për jetën. Dori ishte i lidhur ngushtë me vendlindjen e tij, Kallarat, dhe gjithnjë u përpoq të mbante lidhjet e forta me komunitetin e tij. Ai ishte një bashkëpunëtor i ngushtë i Shoqatës “Kallarati” dhe një fotograf i pasionuar, duke i mbajtur të gjithë bashkëfshatarët e tij të informuar me imazhe dhe kujtime nga vendlindja.

Dori ishte shumë i dashur me nipërit dhe mbesat e tij, duke u bërë për ta një figurë frymë-zuese. Ai e jetonte çdo moment me dashuri dhe bujari, duke e ndarë ngrohtësinë e tij me të gjithë ata që e rrethonin. Me zemrën e tij të madhe, ai fitoi respektin dhe dashurinë e të gjithëve, pran-daj edhe përcjellja e tij për në banesën e fundit më 21 shkurt 2025 në vendlindje në Kallarat ishte një dëshmi e kësaj dashurie. Me nderime të mëdha dhe një pjesëmarrje të jashtëzakonshme, varri i tij u mbush me kurora dhe lule, një skenë që rrallëherë është parë.

Në momentet e fundit, një fjalë lamtumire e goditur dhe prekëse u tha për të, duke nxjerrë në pah vlerat dhe dhimbjen që la pas. Ai ishte dhe do të mbetet një simbol i forcës, përkushtimit dhe shpirtit të paepur. Për të përjetësuar kujtimin e tij, duhet të shqyrtohet mundësia që emri i Dorit të mbetet i gdhendur në historinë e Kallaratit, ndoshta me një rrugë, një objekt historik apo kulturor që të mbajë emrin e tij.



IN MEMORIAM

NJOFTIM PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA TË FATMIR SALO MATAJ

Kryesia e shoqatës “Kallarati” dhe familja Mataj, njoftojnë për ndarjen e parakohshme nga jeta më 25 janar 2025 të Fatmir Salo Mataj, bashkëshorti i Melihasë, babai i Anës, vëllai i Lutmirës, Begos, Gëzimit, Astritit, Jenos e Nestit (ndarë nga jeta).

Fatmiri lindi në Kallarat më 2 shkurt të vitit 1956 në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e atdhetare nga prindërit Salo e Merjeme Mataj.

Fëmijërinë e tij e kaloi mes vështirësish e vuajtjesh si gjithë fëmijët e atij brezi, por me dëshirën dhe vullnetin për dije e arsim.

Pas përfundimit me rezultate të larta të shkollës 8 - vjeçare “Mumin Selami” në Kallarat dhe të shkollës së Mesme Pedagogjike në Fier, Fatmiri nga viti 1974 -1975 punoi mësues në Kurbnesh të Mirditës. Në vitet 1976 - 1980 përfundoi me rezultate të larta shkollën e lartë për Histori - Gjeografi në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës dhe në mbarim emërohet mësues në Lis të Burrelit, ku punoi me përkushtim e devotshmëri 8 vjet rresht derisa u transferua në rrethin e Vlorës pranë familjes dhe njerëzve të tij. Aktiviteti dhe kontributi i Fatmirit në edukimin e arsimimin e brezave të tërë nxënësish në rrethin e Vlorës është i njohur e vlerësuar nga të gjithë si mësues i shkëlqyer, mësimsdhënës i apasionuar ndaj historisë së vendit tonë dhe asaj botërore, por edhe si drejtor shkolle në disa shkolla 9 - vjeçare e të mesme, duke filluar nga Kuçi i largët, Brataj, Lepenicë, Kotë, Novoselë dhe në disa shkolla



publike e jopublike të qytetit të Vlorës deri sa doli në pension e mbyllur me sukses e dinjitet të lartë karrierën në arsim e duke mbetur kështu shembull frymëzimi për brezat e rinj si simbol i përkushtimit, karrektesisë, profesionalizmit

dhe dashurisë ndaj figurës së nderuar e të respektuar të mësuesit në shoqëri.

Për kontributin e tij në arsim prej më shumë se 40 vjetësh, duke filluar në veri në vitin 1980 e duke e mbyllur me nder në qytetin e Vlorës

në vitin 2021, Fatmiri është nderuar nga Bashkia e Vlorës me titullin: “MIRËNJOHJE E QYTETIT TË VLORËS” me motivacionin: “Për kontributin e dhënë në vite në fushën e arsimit, për konsolidimin e shkollës, për edukimin shkencor e atdhetar të shumë brezave të nxënësve. Si shenjë vlerësimi dhe simbol i përkushtimit të figurës së ndritur të mësuesit”.

Fatmir Mataj, një ndër mësuesit nga Kallarati me një kontribut të vlerësuar në arsimin shqiptar me daljen në pension para tre vitesh, nuk e shkëputi aktivitetin e tij shoqëror në interes të mbarë shoqërisë, e në veçanti ndaj qytetit të Vlorës, vendlindjes së tij e shoqatës Kallarati.

Fatmiri ishte martuar me Melihanë, me të cilën lindën vajzën e vetme Anën, e cila duke ecur në gjurmët e babait, po ngjiti një nga një shkallët e karrierës profesionale dhe akademike në fushën e drejtësisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në momentin që Fatmiri do të gëzonte jetën në pension së bashku me familjen, një sëmundje e shpejtë dhe e papritur i mori jetën duke e ndarë para kohe nga bashkëshortja, vajza, vëllezërit, të afërmit dhe shoqëria e tij.

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” i shpreh familjes së tij, bashkëshortes, vajzës e motrës së vetme, vëllezërve, të afërmeve ngushëllimet më të sinqerta për ndarjen e parakohshme të njeriut të tyre të dashur.

Qoftë i paharruar kujtimi i Tij!
U prehtë në Paqe!

IN MEMORIAM

NJOFTIM PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA TË BEQARE JONUZAJ

Kryesia e shoqatës Kallarati dhe familja Jonuzaj në Penkovë me origjinë nga Kallarati, njoftojnë se 16 shkurt 2025 u nda para kohe nga jeta Beqare Jonuzaj e datëlindjes 1 mars 1958, bashkëshortja e Kastriotit, nëna e Entilit, Aurorës dhe Lorenës, gjyshja e Troit.

Kryesia e shoqatës Kallarati u shpreh ngushëllimet më të thella bashkëshortit, fëmijëve dhe fisit Jonuzaj për ndarjen e parakohshme të njeriut të tyre të dashur.

Qoftë i paharruar kujtimi i Saj!

U prehtë në Paqe!



Kryesia e Shoqatës “Kallarati” u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

8 mars 2025. Në ditën e nënës



1 MARS 2025. NGA AKSIONI PËR MBJELLJEN E PEMËVE, NË KUADËR TË NISMËS "MBILL EDHE TI NJË PEMË"



Ec ngado **KALLARATIN** *mos e harro!*



KRYEREDAKTOR: LEFTER HYSAJ

REDAKSIA E GAZETËS: ANËTARË:

Prof. dr. Rami MEMUSHAJ,
Hiqmet MEÇAJ,
Çize XHAFAJ,
Eleni MEMUSHAJ,
Besnik GJONBRATAJ,
Riza MEMUSHAJ,
Selo OEJVANI.

REDAKTOR/ KORREKTOR:

Prof. Dr. Rami Memushaj

GRAPHIC DESIGNER:

A. Hysaj